

RAPORT I AVOKATIT TË POPULLIT

MBROJTJA E FËMIJËVE NGA ABUZIMI DHE
SHFRYTËZIMI SEKSUAL

NJË NDËR SHKELJET MË TË RËNDA TË TË
DREJTAVE TË FËMIJËVE

NËNTOR 2021

PËRMBAJTJA

Hyrje

Qëllimi

Metodologjia e raportit

1. Korniza e legjislacionit ndërkombëtar dhe harmonizimi në legjislacionin kombëtar

1.1 Parimet drejtuese të Konventës për të Drejtat e Fëmijës

1.2 Shtyllat kryesore të Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual (Konventës së Lanzarotës)

1.3 Instrumentat evropiane për luftimin e abuzimit dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve

2. Panoramë e përgjithshme mbi situatën e abuzimit seksual ndaj fëmijëve në Shqipëri

3. Roli i institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, viktimat të abuzimit seksual në Shqipëri

Përfundime dhe rekomandime

Shkurtime

| | |
|--------|--|
| AKSHI | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit |
| ASHDMF | Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve |
| ASCAP | Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar |
| AMA | Autoriteti i Mediave Audiovizive |
| AP | Avokati i Popullit |
| ASHDMF | Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve |
| BE | Bashkimi Evropian |
| CRCA | Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri |
| DUDNJ | Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut |
| DRSH | Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë |
| GDMF | Grupi i Deputetëve ‘Miq të Fëmijëve’ |
| GTN | Grupi Teknik Ndërsektorial |
| INSTAT | Instituti i Statistikave |
| IPSH | Institucione të Përkujdesit Shoqëror |
| IZHA | Instituti për Zhvillimin e Arsimit |
| KDF | Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve |
| KIE | Këshilli i Evropës |
| KP | Kodi Penal |
| KL | Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual (Konventa e Lanzarotës) |
| KDF | Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve |

| | |
|--------|--|
| KKMDF | Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve |
| KDPM | Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur |
| MASR | Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë |
| MB | Ministria e Brendshme |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| NJMF | Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve |
| NJQV | Njësi të Qeverisjes Vendore |
| NJVNR | Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit |
| OBSH | Organizata Botërore e Shëndetësisë |
| OJF | Organizata Jofitimprurëse |
| OZHQ | Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm |
| PMF | Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve |
| KMPDF | Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve |
| SC | Save the Children |
| SMPDF | Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve |
| SHSSH | Shërbimi Social Shtetëror |
| TDH | Terre des Hommes |
| UNICEF | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët |
| WV | World Vision Albania |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Raporti është hartuar në zbatim të rekomandimeve të Rezolutës së miratuar në datën 7.7.2021 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2020” në lidhje me angazhimin e institucionit të AP për hartimin e një raporti të detajuar në lidhje me *abuzimin seksual ndaj të miturve*. Raporti ndjek një rend kronologjik për masat që duhet të merrën nga organet e administratës shtetërore në nivel qendror dhe vendor për të siguruar identifikimin, vlerësimin individual cilësor të nevojave për mbrojtjen dhe mbështetjen të fëmijëve viktime të abuzimit seksual, në një qasje të bazuar në të drejtat e fëmijës, që respekton dinjitetin e fëmijës, duke synuar shmangien e viktimizimit dhe përfshirjen e fëmijës, si aktor të plotë gjatë procesit në përputhje me standardet dhe instrumentat ligjorë ndërkombëtarë.

Hyrje

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, si fushë kryesore të veprimtarisë së tij ka promovimin, parandalimin e shkeljes dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtat e fëmijës.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij kushtetuese, ligjore dhe administrative institucioni i Avokatit të Popullit, në përmbushjen e kompetencave dhe detyrave të tij, udhëhiqet ndër të tjera nga Parimet e Parisit, Konventës për të Drejtat e Njeriut, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Parimet e Venecias, Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, Kartës Sociale Evropiane etj.

Avokati i Popullit që në ngritjen dhe funksionimin e tij, e ka trajtuar brenda kompetencave ligjore mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijës. Por, ndryshimet ligjore në ligjin për Avokatin e Popullit përmbushën standardin themelor të Parimeve të Parisit, atë të ngritjes dhe fuqizimit të mekanizmave të pavarur monitorues, për identifikimin dhe nxjerrjen në pah të veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme e të parregullta nga ana e organeve shtetërore, të cilat ndikojnë drejtëpërdrejt tek fëmijet, duke krijuar për herë të parë në vitin 2014, funksionin e Komisionerit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve (KMPDF) dhe Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve (SMPDF). Ky pozicion u plotësua për herë të parë në vitin 2018.

Institucioni i Avokatit të Popullit mbështetur nga Komisioneri i Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve dhe ekspertëve të SMPDF, monitoron zbatueshmërinë e kuadrit ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar në fushën e të drejtave të fëmijëve nga ana e organeve të administratës shtetërore në nivel qendror dhe vendor, të cilat janë pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës dhe që me veprimet dhe mosveprimet e tyre çënojnë të drejtat e fëmijës.

Bazuar në trajtimin e gjerë, që mjetet e komunikimit publik, masmedia, tv, mediat online i kanë bërë dukurisë së abuzimit dhe shfrytëzimit seksual, si një ndër format më të rënda të dhunës tek fëmijët, Avokati i Popullit ka marrë dijeni për shumë raste të shkeljes të të drejtave të fëmijës, abuzimit dhe shfrytëzimit seksual. Fenomeni i abuzimit seksual të fëmijës nuk është një fenomen që i përket vetëm Shqipërisë, por është një fenomen global, shtrirja e të cilit nuk dihet me saktësi për shkak të vështirësisë që kanë fëmijët në raportimin dhe denoncimin e këtij fenomeni.

Mbrojtja e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit është një e drejtë themelore e njeriut, në këtë rast e individit fëmijë. Institucionet

shtetërore dhe ato publike, shoqëria civile, komunitetet dhe familja, kanë detyrimin të krijojnë një mjedis që edukon, mbrohet dhe kujdeset për të gjithë fëmijët e një vendi. Abuzimi dhe dhuna seksuale, shfrytëzimi seksual i degradon fëmijët dhe mund t'u shkaktojë atyre dëmtime serioze në zhvillimin psiko-motor, emocional e shoqëror. Si shoqëri ne kemi përgjegjësi kolektive për të parandaluar dhunën dhe abuzimin seksual tek fëmijët. Për këtë, ne duhet të iniciojmë dhe mbështesim shërbime dhe politika, që synojnë rritjen dhe zhvillimin, shëndetin dhe sigurinë e fëmijës.

Reduktimi dhe zbutja e dhunës ndaj fëmijëve, me synim eliminimin e saj është një nga qëllimet më të rëndësishme të strategjive dhe programeve sociale në të gjitha vendet e BE-së, në përputhje me përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, 2030.

Institucioni i AP-së, si institucion i mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe veçanërisht të fëmijëve, shoqëria civile, aktorët kyç të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, duhet të advokojnë për politika dhe programe, për të ndihmuar në plotësimin e nevojave themelore të fëmijëve, në përputhje me moshën dhe nevojat e tyre dhe të familjeve të tyre, duhet të promovojnë kërkime dhe trajnime, si dhe arsim publik cilësor, me qëllim forcimin e faktorëve mbrojtës, të cilët zvogëlojnë ndikimin e faktorëve të riskut.

Në këtë kuptim, institucioni i AP-së me përgjegjshmëri dhe përgjegjësi maksimale është përpjekur të sjellë në vëmendje të autoriteteve shtetërore dhe opinionit publik nëpërmjet trajtimit dhe shqyrtimit të ankesave/kërkesave/rasteve me iniciativë se mbrojtja e fëmijës nga abuzimi apo shfrytëzimi seksual është detyrë e të gjithëve.

Për këtë ka kryer edhe inspektime, monitorime dhe hetime administrative, në përfundim të të cilave janë adresuar rekomandimet përkatëse, por jo vetëm. Avokati i Popullit ka kryer veprimtari me karakter promovues, me fokus përmirësimin e politikave për zbatimin e programeve e shërbime efektive parandaluese dhe trajtuese, për të forcuar në tërësi kapacitetet e sistemeve të mbrojtjes dhe ofrimit të shërbimeve ndaj fëmijëve të abuzuar seksualisht, duke gjykuar si të nevojshme edhe hartimin në vijimësi të një raporti të veçantë për fenomenin e abuzimit apo shfrytëzimit seksual të fëmijës në vendin tonë.

Përmbajtja

Raporti është mbështetur në vlerësimin dhe analizimin e kuadrit ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar, në lidhje me dukurinë e abuzimit seksual, si një ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijës, kryer ndaj kësaj kategorie të veçantë dhe të pambrojtur të shoqërisë tonë. Synimi i tij është pasqyrimi në mënyrë

gjithëpërfshirëse i kësaj dukurie, pasojat dhe masat e ndërmarra për ta parandaluar atë në nivel kombëtar. Pjesa e parë e raportit pasqyron standardet që parasheh kuadri ligjor ndërkombëtar dhe, harmonizimi i tyre në legjislacionin e brendshëm. Konkretisht, janë parashtruar aktet ndërkombëtare, të cilat rregullojnë çështjen e abuzimit seksual të fëmijës që ofrojnë qartësi konceptuale bazuar në të drejtat e fëmijës, të harmonizuara në dispozita ligjore të legjislacionit të brendshëm. Pjesa e dytë pasqyron reagimin institucional, koordinimin, bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës në nivel institucional, si dhe kapacitetet për zbatimin e kuadrit ligjor, si dhe funksionet kryesore të mbrojtjes së fëmijës së abuzuar apo shfrytëzuar seksualisht që nga fillimi i procesit të identifikimit, vlerësimit, mbrojtjes së viktimës së abuzuar seksualisht, duke sugjeruar mënyra cilësore dhe efektive të funksionimit të tyre. Në pjesën e tretë pasqyrohet situata e dukurisë së abuzimit seksual në vendin tonë bazuar në raporte të ndryshme të përgatitura nga organizatat ndërkombëtare dhe jofitimprurëse. Pjesa e katërt është e fokusuar tek praktika administrative e institucionit të Avokatit të Popullit, gjeneruar nga rastet e ndërmarra me iniciativë, të dhënat e mbledhura nga hetimet administrative të realizuara, si dhe analizë e pasojave të shkaktuara nga abuzimi seksual tek fëmijët. Ndërsa, në pjesën e fundit pasqyrohen përfundimet dhe rekomandimet, bazuar në analizën krahasuese të legjislacionit shqiptar me legjislacionin ndërkombëtar dhe politikave të ndryshme që duhet të ndërmerren në këtë fushë.

QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E RAPORTIT

Nisur nga kompleksiteti dhe ndjeshmëria që dukuria e abuzimit seksual dhe pasojave të rënda traumatike që passjell ajo në zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror dhe social, si dhe gëzimin e një jetese të shëndetshme e pa privime të fëmijës, në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr.8454/1999, “*Për Avokatin e Popullit*”, të ndryshuar, institucioni ynë, paraqet raportin e veçantë “**Për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, një ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve**”, me qëllim adresimin e gjetjeve dhe problematikave, si dhe rekomandimeve adresuar organeve shtetërore, pjesë të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në drejtim të luftës kundër abuzimit seksual të fëmijës në tre drejtime kryesore:

- fuqizimin e kapaciteteve njerëzore dhe burimore në orientimin e punës së tyre drejt **programeve parandaluese** për shkelësit e ligjit dhe ndryshimin e modeleve të sjelljes në shoqëri;
- përmirësimin e **legjislacionit penal** në plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa e Lanzarotës, veçanërisht të raundit të dytë të monitorimit;
- mbrojtjen e viktimës (fëmijës së abuzuar seksualisht), duke ofruar shërbime sociale të specializuara multifunksionale nga të gjitha strukturat

përkatëse të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, për të siguruar që **viktimat** të marrin **mbështetjen e duhur dhe holistike**.

METODOLOGJIA

Për këtë raport është përdorur një metodologji mikse, duke gërshetuar të dhënat sasiore dhe cilësore. Për të dhënat e përdorura ka shërbyer informacioni i gjeneruar nga institucionet përgjegjëse të administratës shtetërore, si dhe hetimi administrativ që institucioni i Avokatit të Popullit ka kryer gjatë tre viteve të fundit për rastet e trajtuara, me objekt mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha format e dhunës, konkretisht për periudhën kohore 2018-2021 bazuar dhe në raportet e publikuara nga institucionet e administratës shtetërore.

Analiza e të dhënave

Burimi parësor i përdorur në hartimin e këtij raporti, janë të dhënat e përfituara gjatë realizimit të hetimeve administrative, nga inspektimet dhe monitorimet e kryera në organet shtetërore në nivel vendor konkretisht, në institucionet e edukimit, komisariatet e policisë, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës, bashkitë, prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe institucionet e privimit të lirisë për të mitur.

Një analizë e detajuar *kualitative (cilësore)* është realizuar nga gjenerimi i informacioni, nëpërmjet komunikimit administrativ, që institucioni i Avokatit të Popullit ka realizuar me autoritetet shtetërore, gjatë procesit të trajtimit të problematikave të konstatuara në ankesat/kërkesat/rastet me iniciativë, ku objekti i shqyrtimit të çështjes ka qenë fenomeni i abuzimit seksual tek të miturit.

Burime të tjera informacioni janë përdorur në këtë raport nëpërmjet një kërkimi të thelluar, bazuar në faqet zyrtare të organizatave dhe agjensive (UNICEF-it, Terre des Hommes, INSTAT, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Këshillit të Evropës, etj.), për të bërë një përshkrim të hollësishëm të shkallës së problemit, shërbimet parandaluese për minimizimin e këtij fenomeni, që ofrohen nga sektorët: social, shëndetësor, arsimor, policor dhe drejtësisë, si dhe nga organizatat e shoqërisë civile.

Në tërësi është kryer vlerësimi dhe analizimi i informacioneve, provave, dokumentacionit dhe deklarimeve të administruara nga institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, si dhe burimeve nga raporte të ndryshme të organizatave të shoqërisë civile për të evidentuar, analizuar dhe identifikuar veprimet ose mosveprimet e ndërmarra nga organet shtetërore.

Metodologjia mikse e përdorur bazuar, në vlerësimin e hollësishëm të të gjitha të dhënave së bashku, për të marrë rezultatin tërësor të praktikave administrative të ndjekura për parandalimin, mbrojtjen dhe integrimin e fëmijëve, viktimat të dhunës së abuzimit apo shfrytëzimit seksual, hodhi dritë në identifikimin e mangësive serioze dhe, për rrjedhojë angazhimin e institucionit të Avokatit të Popullit, që përmes këtij raporti të sjellë në vëmendje të organeve të administratës shtetërore, përmirësimin e veprimeve të mëtejshme parandaluese, bazuar në evidenca konkrete.

1. Korniza e legjislacionit ndërkombëtar dhe harmonizimi në legjislacionin kombëtar

Të drejtat e fëmijës kanë një rëndësi të veçantë në mbarë botën e civilizuar. Një sërë konventash ndërkombëtare përcaktojnë parimet dhe standardet kryesore, që duhet të ndjekin dhe respektojnë shtetet, kur trajtojnë këtë kategori të pambrojtur të shoqërisë. Për herë të parë, statusi i fëmijës është parashikuar në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ,) e shpallur në vitin 1948¹, në të cilën nënat dhe fëmijët kanë të drejtën për kujdes dhe ndihmë të posaçme. Ky dokument ndërkombëtar u pasua nga shumë dokumente të tjerë ndërkombëtarë që kanë përcaktuar parimet kryesore për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës.

Instrumentet rregullatorë ndërkombëtarë, që parashikojnë mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës janë të shumta në numër, të tilla si: konventat²; vendimet dhe rregulloret e detyrueshme³ dhe politikat soft-law⁴,

Konkretisht, le të ndalemi në një parashtrim të shkurtër, të konventave të rëndësishme ndërkombëtare dhe instrumenteve ligjorë, që parashikojnë mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi seksual dhe harmonizimi i tyre në legjislacionin e brendshëm të vendit tonë.

Legjislacioni i brendshëm për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual përbëhet nga ratifikimi i instrumenteve ndërkombëtare, dispozita kushtetuese, legjislacioni

¹ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), ratifikuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e datës 10 dhjetor 1948, nëpërmjet Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme 217

² Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve, miratuar nga rezoluta 44/25 e datës 20 nëntor 1959, e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Komiteti i Palëve në Konventën për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, (Komiteti i Lanzarotë-s), konventa të përgjithshme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që përfshijnë dispozita të posaçme për të drejtat e fëmijëve, konventa të përgjithshme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat në mënyrë indirekte mbrojnë të drejtat e fëmijëve, konventa të posaçme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

³ Direktiva e BE-së 2011/92/EU

⁴ Akte të shkruara si politika, dokumente parimesh, rregullore, udhëzime, rekomandime, të cilat nuk kanë në vetvete fuqinë e ligjit dhe nuk janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Vlera e tyre është e rëndësishme në kuadër të interpretimit të parimeve dhe akteve të ndryshme në mbështetje të të cilave aktet e soft-law lëshohen si dokumenta politikë p.sh., Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijës, 2016-2020

vendas, aktet nënligjore dhe procedurat administrative. Konkretisht, Kushtetuta e RSH-së trajton të drejtën e fëmijës në nenin 54, të saj dhe parashikon, ndër të tjera parimin, se çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi që mund të dëmtojë shëndetin e tij/saj, moralin ose të rrezikojë jetën e tij/saj dhe zhvillimin normal⁵. Gjithashtu, vendi ynë ka ratifikuar konventat ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës të sipërpërmendura, si vijon:

- Konventa për të Drejtat e Fëmijës, ratifikuar me ligjin nr.7531, datë 11.12.1991, “Për ratifikimin e Konventës për të drejtat e fëmijëve”;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, duke u bërë një shtet anëtar i KEDNJ-së;
- Konventa e Lanzarotës, ratifikuar me ligjin nr.10071, datë 9.2.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”.

Në këtë kontekst, dispozitat e konventave ndërkombëtare të ratifikuara janë pjesë e legjislacionit të brendshëm shqiptar. Gjithashtu, theksojmë se Shqipëria është një vend kandidat, por ende nuk është i detyruar të transpozojë direktivat e BE-së. Megjithatë, për shkak të angazhimit të saj në procesin e integritimit në BE, vendi ynë është në procesin e përafrimit të legjislacionit me legjislacionin e BE-së në fusha të të ndryshme.

Avokati i Popullit vlerëson dhe inkurajon punën e realizuar ndër vite, nga shteti shqiptar në hartimin dhe miratimin e legjislacionit të brendshëm⁶ në fushën e të drejtave të fëmijës në përputhje me standardet dhe parimet e konventave të

⁵ Neni 54 (3), i i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

⁶ Ligji nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, hyri në fuqi në qershor të vitit 2017. Ky ligj është përafuar me KDF-në dhe mund të krahasohet me standardet më të përparuara evropiane në këtë fushë. Ligji zgjeron horizontin e të drejtave të fëmijëve, ndërkohë që thekson forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi, duke përfshirë edhe nivelin vendor në veçanti. Ligji parashikon ndërveprim, ndërmjet shërbimeve për fëmijët dhe shërbimeve të mbrojtjes sociale, si dhe bashkërendim me ligjin nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” në kontekstin e ri ligjor dhe administrativ të krijuar nga ndarja e re administrative territoriale në vend; ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2018. Ky ligj forcon konsiderueshëm sistemin e drejtësisë dhe e bashkërendon me KDF-në dhe me standarde dhe norma të tjera ndërkombëtare, që synojnë mbrojtjen e fëmijëve në kontakt me ligjin mbështetur në interesin e tyre më të lartë. *Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur* ka sjell risi në përmirësimin e të drejtave të **të miturve që kryejnë, janë dëshmitar ose viktimë të veprave penale**, dhe ka qasje parandaluese dhe restauruese; ligji nr.7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Dispozitat materiale të ligjit penal lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve përfshihen dhe përcaktohen në Kodin Penal Shqiptar. Tre janë nenet të cilat trajtojnë në mënyrë të posaçme abuzimin seksual të fëmijëve, neni 100, neni 101 dhe neni 108. Nenet e tjera, që rregullojnë aspekte të ndryshme të abuzimit seksual, janë klauzola të përgjithshme, të cilat përfshijnë veprime të dënueshme kundër fëmijëve si një rrethanë rënduese Në vitin 2013, Kodi Penal i janë bërë ndryshime, duke përfshirë disa vepra penale, që parashikojnë dënime më të rënda në fushën e dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë abuzimin seksual dhe shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve.

sipërcituara. Edhe, pse Shqipëria ka bërë progres në harmonizimin e legjislacionit të brendshëm përsa i përket mbrojtjes së fëmijës, legjislacioni shqiptar ka ende sfida, për sa i përket çështje të mbrojtjes së fëmijës nga abuzimi seksual, nisur nga publikimet në rritje të këtij fenomenit në vendin tonë në këto tre vitet e fundit. Pa dyshim, njohuria për fenomenin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijës vjen në rritje, kjo në kontekstin e rritjes së të kuptuarit me karakteristikat dhe tipologjinë e fenomenit, dhe natyrshëm lind nevoja për rishikim të vazhdueshëm të legjislacionit. Në këtë kontekst, AP prezanton më poshtë një analizë të kuadrit të brendshëm ligjor në përputhje me standardet dhe parimet e konventave të sipërcituara dhe evidentimin e mangësive dhe nismat që duhen ndermarrë për përmirësimin e tij në kuadër të mbrojtjes së fëmijës nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual.

1.1 Parimet drejtuese të Konventës për të Drejtat e Fëmijës

Komuniteti ndërkombëtar, kuptoi se individët nën moshën 18 vjeç, shpesh kishin nevojë për një kujdes dhe mbrojtje të veçantë, ndryshe nga të rriturit që nuk e kanë të nevojshme. Në këtë kuptim, u miratua konventa e parë ndërkombëtare dedikuar mbrojtjes së posaçme të të drejtave të fëmijës, Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF), miratuar në vitin 1989, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 1990.

Shteti shqiptar ratifikoi Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, e cila parashikon të drejta dhe detyrime të panegociueshme, për të cilat është rënë dakord botërisht, për mbrojtjen dhe përkrahjen për të drejtat e fëmijës.

Pjesa e parë, e konventës përbëhet nga 41 dispozita ligjore (nene) në përputhje me katalogun e drejtave të njeriut: ekonomike, sociale, zhvillimore, kulturore dhe civile, duke i përshtatur ato me kushtet dhe nevojat specifike të fëmijës. Parimi kryesor që udhëheq këtë konventë për zbatim, gjatë trajtimit të çështjeve që kanë ndikim tek fëmijët, është interesi më i lartë i fëmijës.

Ky parim parasheh, se të gjitha veprimet dhe vendimet që merren nga autoritetet publike e jopublike, si dhe nga institucionet e drejtësisë (prokuroria, gjykata etj), që ndikojnë te fëmijët duhet t'i japin prioritet interesit më të lartë të fëmijës, që nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.

Raporti i të drejtave të fëmijëve me të drejtat e subjekteve të tjera (p.sh, prindërve/kujdestarëve ligjorë etj) ka rëndësi parësore. Të drejtat e fëmijës duhet të mbizotërojnë në çdo vendimmarrje që ka impakt mbi fëmijën, në vlerësim të nevojave të fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe

qëndrueshmëri, si dhe rritjen/përkatësinë në një familje, mendimit, moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar. Në mënyrë të veçantë duke vlerësuar me prioritet situatat e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose formave të tjera të dhunës ndaj fëmijës, historive të tyre duke marrë parasysh rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të mos ndodhin në të ardhmen.

Të gjitha të drejtat janë të barabarta, të pandara dhe të ndërvarura nga njëra tjetra dhe, asnjë e drejtë nuk është më e rëndësishme se tjetra, e për më tepër, të drejtat janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Për shkak të rëndësisë, që po i japim dukurisë të abuzimit seksual tek fëmijët, të drejtat thelbësore që parasheh KDF-ja janë:

- e drejta për t'u mbrojtur⁷ nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore përfshirë abuzimin seksual. Për shkak të rëndësisë së tij, abuzimi seksual, është gjithashtu i rregulluar nga një dispozitë e posaçme e KDF-së;
- e drejta për t'u dëgjuar⁸ në çdo procedurë gjyqësore ose administrative;
- e drejta për të përfituar nga shërbimet dhe lehtësitë e kujdesit për fëmijët⁹ në rrethana të veçanta.

Gjithashtu, në nenin 34, të KDF-së parashikohet, se Shtetet Palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual. Ky parim udhëheq/drejton shtetet që të ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura pozitive, në plane konkrete kombëtare, dypalëshe dhe shumëpalëshe për të parandaluar, që:

- fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale;
- fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme;
- fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike.

Përfundimet: AP vlerëson punën e mirë të kryer nga ligjvënësi shqiptar në hartimin dhe miratimin e ligjit nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” i përafuar me standardet e sipërcitura në KDF-së që mbrojnë fëmijët nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual. Ligji ka sjellë risi, duke parashtruar dhe përkufizimin e parimit të mirënjohur të interesit më të lartë të fëmijës¹⁰. Gjithashtu, në këtë ligj çdo fëmijë gëzon të drejtën për pjesëmarrje në të gjitha nivelet e vendimmarrjes lidhur me jetën e tyre, duke përfshirë dhe sistemin e drejtësisë. Ky ligj parashikon ndërveprim, ndërmjet shërbimeve për fëmijët dhe

⁷ Neni 19 (1), i KDF-së

⁸ Neni 12 (2), i KDF-së

⁹ Neni 18, 19, 20 etj. i KDF-së.

¹⁰ Neni 5 (2) i ligjit nr. 18/2017 datë 23.02.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

shërbimeve të mbrojtjes sociale, si dhe bashkërendim me ligjin nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” në kontekstin e ri ligjor dhe administrativ të krijuar nga ndarja e re administrative territoriale në vend. Ligji nr.18/2017 krijon një kuadër institucional të mirë-organizuar, me disa organe të administratës shtetërore që ushtrojnë funksione të ndryshme në nivel qendror dhe vendor, duke përmbushur standardet e mbrojtjes së fëmijës të sipërcitura më lart në KDF dhe ofrimit të shërbimeve për përkujdesjen e tyre në të gjitha hallkat e procesit të identifikimit, referimit, vlerësimit, mbrojtjes dhe integritetit të viktimës fëmijës të abuzuar seksualisht bazuar në qasjen multidisiplinare.

Një ndër faktet pozitive është se funksionet e çdo organi përshkruhen në mënyrë të detajuar dhe të strukturuar, siç përmbledhet më poshtë:

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (KKDMF): është një organ këshillimor i cili ka si detyrë kryesore këshillimin dhe bashkërendimin e politikave shtetërore për garantimin e të drejtave të fëmijës¹¹. Një detyrë e rëndësishme e këtij organi është vlerësimi i planifikimit të buxhetit nga perspektiva e të drejtave të fëmijëve¹² dhe dhënia e rekomandimeve të posaçme për autoritetet qendrore dhe agjencive përgjegjëse për të drejtat e fëmijëve.

Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës¹³: është autoriteti kryesor përgjegjës për këtë fushë. Ai ka funksione koordinuese në politikat për të drejtat e fëmijëve; funksione monitorimi në lidhje me zbatimin e politikave dhe masave, funksione kontrolli mbi veprimtarinë e ASHDMF-së; funksione mbështetëse për organizatat jo-qeveritare që veprojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve merr masa, në bashkëpunim me ministrat e tjerë, për ngritjen dhe mirëfunksionimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës nëpërmjet shërbimeve shumëdisiplinore; siguron ngritjen e një sistemi akreditimi, për kontrollin e cilësisë të strukturave të mbrojtjes së fëmijës; krijon dhe ngre Regjistrin Elektronik Kombëtar për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Ministrat e tjerë të linjës: Ministrat e tjerë të linjës, brenda fushës së veprimtarisë së tyre shtetërore kanë detyra politikëbërëse në lidhje me të drejtat e fëmijëve. Një detyrë e rëndësishme është të parashikojnë në planet vjetore apo shumëvjeçare buxhetore fondet e nevojshme për përmbushjen e të drejtave të fëmijës dhe për mbrojtjen e fëmijës¹⁴.

¹¹ Neni 35 (1) dhe (2), Ibid

¹² Neni 36 (b) dhe (2), Ibid,

¹³ Neni 38, Ibid

¹⁴ Neni 39, (ç) Ibid,

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF)¹⁵: është agjencia kombëtare qendrore, e cila ushtron një sërë kompetencash të rëndësishme në lidhje me të drejtat e fëmijëve në Shqipëri, të tilla si: organizimi dhe koordinimi i sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës¹⁶; mbështetje të drejtpërdrejtë ndaj strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor duke përfshirë trajnime, asistencë në menaxhimin e rasteve, mbikëqyrje të rasteve të caktuara, këshillim etj¹⁷; mbledhja e të dhënave në nivel kombëtar dhe administrimi i regjistrit elektronik kombëtar për rastet e fëmijës në nevojë për mbrojtje¹⁸; bashkërendimi i punëve me ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve; realizimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe edukative.

Bashkitë: janë përgjegjëse për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative të një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës, duke siguruar ndërmjet të tjerash¹⁹: zhvillimin e programeve dhe projekteve²⁰; mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera; ngritjen e strukturave të mbrojtjes së fëmijës²¹; zbatimin e procedurës për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, ngritjen dhe koordinimin e sistemit të referimit, raportimit, të marrjes në mbrojtje dhe të mbikëqyrjes në vazhdim²²; organizimin dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët në nevojë për mbrojtje, shërbimeve mbështetëse për familjet, si dhe shërbimeve të përkujdesjes alternative për fëmijët²³; ngritjen e programeve dhe të shërbimeve rehabilituese dhe ri-integruese për fëmijët në nevojë për mbrojtje, veçanërisht për fëmijët viktime të dhunës²⁴; etj.

Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki: këto struktura janë në përgjithësi përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes së fëmijës, si dhe kryejnë disa funksione specifike të mbrojtjes së fëmijëve, të tilla si: raportimi tek kryetari i bashkisë dhe këshilli bashkiak për ecurinë e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë²⁵; ngritja e grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie, si dhe koordinimi dhe mbikëqyrja e punës dhe aktivitetit të tij²⁶. Duhet të përmendet se këto struktura kryejnë gjithashtu detyra shumë të rëndësishme në lidhje me **miratimin e masave mbrojtëse** pasi është **Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore** i cili vendos

¹⁵ Neni 40, Ibid,

¹⁶ Neni 41, (1) Ibid,

¹⁷ Neni 41, (2) Ibid

¹⁸ Neni 41, (3) (a) Ibid, i Ligjit nr. 18/2017 datë 23.02.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

¹⁹ Neni 46, Ibid

²⁰ Neni 46, (c), Ibid

²¹ Neni 46, (dh), Ibid,

²² Neni 46, (e), Ibid

²³ Neni 46, (ë), Ibid

²⁴ Neni 46, (f), Ibid

²⁵ Neni 47, (2), Ibid,

²⁶ Neni 47, (3), Ibid

për marrjen e masave mbrojtëse, për miratimin dhe koordinimin e zbatimit të Planit Individual të Mbrojtjes, si dhe për marrjen e masave emergjente 24-orëshe, të cilat më pas i njoftohen strukturave të Policisë së Shtetit²⁷. Për më tepër të gjitha funksionet që lidhen me çështjet e administrimit të përditshëm të rasteve individuale të fëmijëve ushtrohen nga një njësi e posaçme që funksionon brenda kësaj strukture²⁸.

Njësia për mbrojtjen e fëmijës. Njësia për mbrojtjen e fëmijës, përbëhet nga punonjës socialë, të quajtur **punonjësit për mbrojtjen e fëmijës**, të cilët kanë për detyrë ndjekjen e rasteve të fëmijëve viktimë që nga origjina/identifikimi i rastit deri te miratimi i masave dhe zbatimi i tyre. Punonjësit për mbrojtjen e fëmijës kanë, ndër të tjera, disa detyra domethënëse të tilla si: të propozojnë masa mbrojtëse²⁹; të propozojnë ndryshimin apo përfundimin e Planit Individual të Mbrojtjes³⁰; të marrin pjesë në proceset gjyqësore në të cilat shqyrtohen masat e mbrojtjes të propozuara në Planin Individual të Mbrojtjes³¹; t'i drejtohen prokurorit për heqjen e përgjegjësisë prindërore³²; të ndihmojnë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në hartimin dhe dërgimin e ankesave pranë Avokatit të Popullit apo autoriteteve të tjera përgjegjëse³³.

Grupi teknik ndërsektorial: Në çdo bashki dhe në çdo njësi administrative bashkiake, e cila ka mbi 3000 fëmijë, krijohet grupi teknik ndërsektorial i posaçëm (*ad-hoc*), i cili trajton rastet e fëmijës në nevojë për mbrojtje³⁴. Ai përbëhet nga përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve shoqërore, strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jo-qeveritare, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës së abuzuar³⁵. Grupi teknik ndërsektorial mbështet punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe lehtëson referimin dhe menaxhimin e rastit dhe zbatimin e masave të posaçme³⁶.

Konstatimet: Në përmbushje të standardeve ndërkombëtare të harmonizuara në ligjin 18/2017, AP vlerëson ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore në nivel qendror dhe vendor por konstaton, se një ndër detyrat e caktuara ndaj KKDMF për vlerësimin e planifikimit të buxhetit nga perspektiva e të drejtave të fëmijëve dhe dhënien e rekomandimeve të posaçme për autoritetet qendrore dhe agjencive përgjegjëse për të drejtat e fëmijëve për

²⁷ Neni 48, Ibid

²⁸ Neni 49, Ibid

²⁹ Neni 59, (2), Ibid

³⁰ Neni 51, (e), Ibid

³¹ Neni 51, (f), Ibid,

³² Neni 51, (g), Ibid, i Ligjit nr. 18, datë 23.02.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

³³ Neni 51, (gj), Ibid,

³⁴ Neni 52, (1), Ibid,

³⁵ Neni 52, (2), Ibid,

³⁶ Neni 52, (5), Ibid,

këtë çështje, nuk gjejnë zbatim bazuar në rrethanat dhe mënyrën e planifikimit buxhetor. Planifikim i buxhetit është i fragmentizuar në programet buxhetore të ministrive të linjës dhe rekomandimet e KKDMF si mjete ligjore janë soft-law dhe jo detyruese. Fragmentizimet e parashikimeve buxhetore në programe të ndryshme të paintegruara nuk mund të nxjerrin në pah rritjen e fondeve të alokuara për fëmijë në përpjesëtim me nevojat dhe buxhetin e përgjithshëm të shtetit.

Avokati i Popullit, vlerëson përmbushjen e standartit ligjor për ngritjen e Regjistrit Elektronik Kombëtar për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje nga Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës, në rastin konkret Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe merr masa për miratimin e akteve nënligjore për ta bërë të detyrueshëm përdorimin e këtij regjistri³⁷. Përmbushja e këtij detyrimi ligjor është i pjesshëm, pasi ky regjistër është i përfshirë në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, i cili ka si qëllim administrimin e të dhënave të rasteve, individëve/familjeve në nevojë për të përfituar shërbime të kujdesit shoqëror dhe, aksesohet nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore në nivel bashkie e qarku, ndërsa administrohet e përditësohet nga Shërbimi Social Shtetëror, si institucioni administrues. Por, nga gjenerimi i informacionit të marrë në terren nga punonjësit e strukturës së shërbimeve shoqërore, konstatohet, se as Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror³⁸, i cili menaxhohet nga Shërbimi Social Shtetëror, nuk është funksional, pasi ka problematika teknike, për të cilat duhet ndërhyrje që nuk varen nga bashkia. Si rrjedhojë, të dhënat e dedikuara për fëmijët e abuzuar dhe shfrytëzuar seksualisht mbeten vetëm në kuadrin e të dhënave sasiore, të cilat nuk mund të pasqyrojnë vlerësimin real të situatës së fenomenit të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në vendin tonë që passjell dhe mungesën e marrjes së masave konkrete për luftën kundër këtij fenomeni.

AP vlerëson përmbushjen e standardit të vendosur si detyrim ligjor³⁹, për numrin e punonjësve të mbrojtjes së fëmijës (PMF) bazuar në numrin e fëmijëve, konkretisht, një punonjës (PMF) i dedikuar për 3000 fëmijë, për bashkitë e vendit. Nga monitorimet e realizuara AP vëren, se burimet njerëzore janë të pakta dhe të pamjafueshme në raport me numrin e lartë të fëmijëve dhe numrin e rasteve të menaxhuara, si rezultat i mungesës së fondeve buxhetore të bashkive për punësimin e PMF-ve. Moszbatimi i këtij standarti ligjor, passjell

³⁷ Gërma “ë”, pika 2, e nenit 38 të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

³⁸ Në zbatim të legjislacionit të shërbimeve shoqërore, vendimit nr.136, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave “Për funksionimin dhe administrimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror”, Shërbimi Social Shtetëror është struktura përgjegjëse për përditësimin dhe mirëmbajtjen e tij. Regjistri është baza elektronike e të dhënave të përfituesve, subjekteve ofruese, institucioneve përgjegjëse, llojit dhe kohëzgjatjes së shërbimeve të kujdesit shoqëror

³⁹ Ligji nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

mosfunktionimin efektiv të strukturës dhe mandatit të NJMF, kundrejt detyrave dhe përgjegjësive që i ngarkon ligji në fushën e mbrojtjes së drejtave të fëmijëve dhe në veçanti, të fëmijëve të abuzuar seksualisht. Punonjësit për mbrojtjen e fëmijës (PMF) janë pjesë e strukturës së brendshme të njësisë administrative dhe, në këtë rast, ligji përcakton qartë rolin e PMF-ve pranë njësive administrative⁴⁰, të cilët janë pjesë e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe, mbartin dhe shumë detyra të tjera në drejtim të parandalimit të fenomenit të abuzimit seksual tek fëmijët. Numri i ulët në tërësi të tyre sjell mospërbushjen e detyrave dhe cilësi të ulët shërbimi në drejtim të mbrojtjes së fëmijës në përgjithësi, dhe fëmijëve të abuzuar seksualisht në veçanti.

Për sa më sipër, institucioni i AP-së, në shqetësim të problematikës së sipërcituar lidhur me plotësimin e standartit ligjor të parashikuar në ligjin nr.18/2017, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me INSTAT, kërkoi të dhëna sasiore, për numrin e fëmijëve nga 0 - 18 vjeç për çdo bashki. Në përgjigjen e tij, INSTAT informoi, se kjo e dhënë nuk mund të gjenerohet nga të dhënat, që ky institucion disponon, por premtoi, se në CENSUS-in që pritet të realizohet së shpejti, do të përfshihet edhe prodhimi i kësaj të dhëne, që zgjidh njëherë e mirë problematikat që lidhen me numrin e punonjësve të mbrojtjes së fëmijës për çdo bashki. Në këtë kuptim, Avokati i Popullit do të ndjekë me përparësi realizimin e këtij standarti.

Avokati i Popullit vlerëson përbushjen e standartit të mbrojtjes së fëmijës bazuar në qasje multifunksionale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN) në çdo bashki të vendit. Gjithashtu, dhe miratimi i akteve nënligjore, si rregullorja e funksionimit të grupit teknik ndërsektorial⁴¹ që është një nga mekanizmat kryesorë vendorë, i cili mbështet punonjësin e mbrojtjes së fëmijës në hartimin e planit individual të mbrojtjes, lehtëson referimin e tij, si dhe zbatimin e ndërhyrjeve apo veprimeve të përcaktuara në këtë plan. Me keqardhje konstatojmë se në këtë GTN nuk janë përfshirë punonjësit e prokurorisë dhe gjyqësorit në mënyrë eksplicite duke mos e bërë detyruese pjesëmarrjen e tyre në GTN, element i rëndësishëm në drejtim të mbledhjes së provave dhe fakteve të ndodhive të fenomenit të abuzimit seksual bazuar në mbrojtjen e viktimës. Gjithashtu, AP sjell në vëmendje të bashkisë, PMF/NJMF-ve se duhet të referojë tek ASHDMF rastet kur, autoritetet shtetërore nuk bashkëpunojnë e ndihmojnë në aksesin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe ASHDMF duhet të jetë më efektive në zbatim të sanksioneve në rastet e kundravajtjeve administrative, sipas parashikimeve ligjore⁴², në rastet e

⁴⁰ Ligji nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, neni 50 “Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në njësiti administrative të bashkisë”.

⁴¹ Vendimi nr.353, datë12.6.2018, i Këshillit të Ministrave “Për rregullat e funksionimit të GTN-ve për mbrojtjen e fëmijëve në bashki dhe njësi administrative ”

⁴² Neni 69 i Ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, parasheh se “...Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është organi, i cili konstaton kundërvajtjen administrative, vendos dhe ekzekuton sanksionet administrative...”

konstatimit të mospërbushjeve të detyrimeve ligjore ndaj punonjësve dhe organeve të administratës publike të parashikuara në këtë ligj.

1.1 Shtyllat kryesore të Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual (Konventës së Lanzarotës)

Për shkak të dëmit të konsiderueshëm, që dhuna dhe çdo formë e saj shkakton në zhvillimin e fëmijës, abuzimi seksual i fëmijëve është një ndër çështjet kryesore, i trajtuar gjerësisht në instrumentet e veçanta ndërkombëtare.

Në këtë kuptim, është miratuar në tetor të vitit 2007, Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, në Lanzarotë⁴³, nga ka marrë edhe emrin. Në parathënie të konventës është përcaktuar, se shfrytëzimi seksual i fëmijëve dhe të gjitha format e abuzimit seksual janë shkatërruese për shëndetin dhe zhvillimin psiko-social të fëmijëve dhe, se kjo dukuri është bërë shqetësuese, si në nivelin kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Konventa e Lanzarotë-s e përkufizon abuzimin seksual si: *“Përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë, i cili sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit kombëtar nuk e ka arritur moshën ligjore për aktivitete seksuale. Përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë ku; përdoret shtrëngimi forca apo kërcënimi ose; abuzimi bëhet nga një pozicion i njohur i besimit, autoritetit ose influencës mbi fëmijën duke përfshirë dhe brenda familjes; ose abuzimi bëhet nga një situatë veçanarisht e cënueshme e fëmijës, përkatësisht për shkak të aftësisë së kufizuar mendore dhe fizike e fëmijës ose të një shtate të varësisë⁴⁴.*

Konventa e Lanzarotë-s përbëhet nga një grup nenesh gjithëpërfshirëse dhe të detajuara, që synojnë të mbulojnë dhe rregullojnë të gjitha aspektet e fenomenit të abuzimit seksual të fëmijëve. Tre janë shtylla kryesore të saj:

- masat parandaluese;
- masat mbrojtëse dhe ndihmëse;
- masat gjatë procesit të ndjekjes penale.

Masat Parandaluese janë të parashikuara në nenin 4, të Konventës së Lanzarotës. Ato synojnë marrjen e masave të nevojshme legislative ose masave

⁴³ Konventa e Lanzarotës është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin 10071, datë 9.2.2009, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual”

⁴⁴ Shih nenin 18, të ligjin 10071, datë 9.2.2009, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual”

të tjera për parandalimin e të gjitha formave të abuzimit seksual të fëmijëve nga shtetet palë. Në këtë kontekst, nenet e konventës parashikojnë një gamë të gjerë masash me natyrë ligjore dhe nivel të ndryshëm zbatimi. Ato mund të jenë politika publike, masa administrative ose masa penale, secila e hartuar për të ngritur një sistem parandalimi që ka aftësinë të ndërhyjë në faza të ndryshme të abuzimit seksual të fëmijëve. Konkretisht:

- **politikat e ndërgjegjësimit/edukimit** të hartuara për një kategori të gjerë subjektsh (fëmijët, personat që punojnë në kontakt me fëmijët, publiku i gjerë) me qëllim për të ofruar njohuri për dukurinë e abuzimit seksual të fëmijëve. Ato duhet të jenë të konceptuara në mënyrë që të jenë të përshtatshme me kategorinë të cilës i adresohen⁴⁵;
- **politikat e trajnimit** që u ofrohen personave që punojnë me fëmijët në sektorë të ndryshëm, si arsimit, shëndetësia, mbrojtja sociale, gjyqësori, organet e zbatimit të ligjit, sporti dhe kultura⁴⁶;
- **masat kufizuese** për personat që janë dënuar, për veprime të shfrytëzimit seksual ose abuzimit seksual të fëmijëve përjashtohen nga profesionet që kanë kontakt të rregullt me fëmijët⁴⁷.
- **masat e bashkërendimit/koordinimit**⁴⁸, sipas të cilave kërkohet që agjencitë dhe institucionet vendore dhe kombëtare që veprojnë në sektorë të ndryshëm në kontakt me fëmijët (arsim, shëndetësi, shërbime sociale, organet ligjzbatuese, gjyqësori), të bashkëpunojnë në koordinimin e aktiviteteve të tyre, në mënyrë që të ndërtojnë një sistem parandalimi efektiv;
- **masat e legjislacionit penal**, të cilat janë masa parandaluese në vetvete për shkak të efektit parandalues, që ligji penal mendohet se ka në veprimtarinë kriminale të individëve. Në fakt, Konventa e Lanzarotë-s përcakton një sërë dispozitash të hollësishme penale, duke konsideruar si vepra penale disa aktivitete seksuale me fëmijët⁴⁹.

⁴⁵ Nenet 5,6 dhe 8, të Konventës së Lanzarotë-s.

⁴⁶ Neni 5 (1) dhe (2) të Konventës së Lanzarotë-s.

⁴⁷ Neni 5 (3) të Konventës së Lanzarotë-s

⁴⁸ Neni 10 i Konventës së Lanzarotë-s

⁴⁹ **Neni 18 – Abuzimi seksual** - i cili përcakton se palët e konventës duhet të parashikojnë si vepër penale sjelljen e qëllimshme të: „(a) përfshirjes në aktivitete seksuale me një fëmijë, i cili, sipas dispozitave të legjislacionit të brendshëm, nuk e ka arritur ende moshën ligjore për aktivitete seksuale; (b) përfshirjes në aktivitete seksuale me një fëmijë me mjete shtrënguese, forcë ose kërcënime; kur abuzohet me një pozicion të njohur që gëzon besim, autoritet ose ndikim mbi fëmijët, duke përfshirë edhe marrëdhëniet brenda familjes; kur abuzohet në veçanti me situatën karakteristike të brishtë të fëmijëve, kryesisht për shkak të një paaftësie mendore ose fizike ose të një situatë varësie”. **Neni 22- Korruptimi i fëmijëve** – në përputhje me të cilin palët e konventës duhet të parashikojnë si vepër penale “ shkaktimin me qëllim, për qëllime seksuale, të një fëmije ... për të qenë dëshmitar i abuzimit seksual ose i aktiviteteve seksuale, edhe pa iu dashur të marrë pjesë në to”. **Neni 24** i cili parashikon si vepër penale ndihmën ose lejin dhe tentativën e abuzimit seksual mbi fëmijën dhe **Neni 28 dhe 29** i cili identifikon disa rrethana rënduese. Vlen të përmendet, se Konventa lë të hapur për shtetet të përcaktojnë **moshën nën të cilën ndalohet përfshirja në aktivitete seksuale të një fëmije**, që do të thotë se mund të jetë edhe më e ulët se moshë 18 vjeç. Kjo pavarësisht dispozitës së nenit 3, që parashikon se fëmijë është çdo person nën moshën 18 vjeç. Kjo ndodh për shkak të faktit se sisteme të ndryshme ligjore parashikojnë moshë të ndryshme ku

Përfundimet: AP vlerëson përmirësimin e dukshëm të legjislacionit të brendshëm për mbrojtjen e fëmijës duke përfshirë dhe rregulluar në mënyrë të detajuar dhe sistematike parimet, standardet dhe masat e parashikuara në Konventën e Lanzarotë-s dhe në instrumentet e tjera ndërkombëtare të përmendura në këtë raport. Konkretisht, ligji nr. 18/2017 përcakton: (i) **masat parandaluese** të tilla si: trajnime, fushata për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi drejtuar personave që punojnë me fëmijët, punonjësve të administratës publike dhe qytetarëve⁵⁰; kufizime të punësimit në kontakt me fëmijët për shtetasit që janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale kundër personit, ose ndaj të cilëve janë marrë, me vendim gjykate, një nga masat mbrojtëse të parashikuara për dhunën në familje⁵¹; pezullimi i punësimit për shtetasit që punojnë me fëmijët kur ndaj tyre fillon një procedim penal për vepra penale të kryera ndaj fëmijës⁵².

Konstatime: Avokati i Popullit, nisur nga praktika administrative, gjatë periudhës kohore 2018-2021, kanë vërjetur që një ndër kërcënimet e kryerjes së veprave penale të natyrës seksuale ka ardhur si rezultat i punësimit të personave që kanë patur procedime penale (rasti i Tiranës dhe Beratit). Kjo, vjen jo si rrjedhojë e mungesës së parashikimeve ligjore të sipërcitura por, pasi institucionet përgjegjëse shtetërore në rolin e punëdhënësve nuk kanë mundur të zotërojnë informacionin e duhur nga vlerësimi i dokumentacioneve të punëmarrësit. Në këtë kontekst, dhe në zbatim të masave parandaluese, të parashikuara në nenin 4, të Konventës së Lanzarotë-s, mbështesim nismën ligjore për hartimin dhe miratimin e Regjistrimit Kombëtar të të Dënuarve për Krimet Seksuale në Shqipëri nga KRSH-së, si një masë parandaluese, për mbrojtjen dhe parandalimin e çdo lloj abuzimi apo krimi seksual ndaj fëmijëve dhe, jo vetëm.

Masat mbrojtëse dhe ndihmëse janë të parashikuara në kreun IV, të Konventës së Lanzarotës. Konkretisht, masat që parashikohen janë si vijon:

- krijimi i **strukturave shumëdisiplinore** që u japin mbështetjen e nevojshme viktimave dhe të afërmeve të tyre të rrethit të ngushtë⁵³;
- **raportimi i dyshimit** mbi rastes e abuzimit seksual nga profesionistët që punojnë në kontakt me fëmijët⁵⁴;
- krijimi i shërbimeve të informimit si linja telefonike ose interneti⁵⁵;

konsiderohet se personi ka aftësinë të japë pëlqimin për kryerjen e marrëdhënieve seksuale, madje edhe moshën 14 vjeç³⁰ siç është dhe rasti i Shqipërisë.

⁵⁰ Neni 43 (2), Ibid.

⁵¹ Neni 45 (1), Ibid.

⁵² Neni 45

⁵³ Neni 11, i Konventës së Lanzarotës

⁵⁴ Neni 12 (1) i Konventës së Lanzarotës

⁵⁵ Neni 13,) i Konventës së Lanzarotës

- **ndihma e viktimave**, në **kuadrin afatshkurtër dhe afatgjatë**, gjatë rimëkëmbjes së tyre fizike dhe psiko-sociale⁵⁶;
- **bashkëpunimi** me organizatat jofitimprurëse dhe/ose shoqërinë civile të angazhuara në ndihmën ndaj viktimave⁵⁷;
- **largimi** i autorit ose largimi i viktimës nga mjedisi familjar, kur abuzimi seksual i fëmijëve ndodh brenda rrethit të besimit ose familjes⁵⁸.

Përfundimet: Lidhur me masat mbrojtëse dhe ndihmëse, AP vlerëson përmbushjen e këtij standarti të harmonizuar në parashikimet ligjore të ligjit nr.18/2017, konkretisht, **masat ndihmëse dhe mbështetëse** të tilla si: ndihmë juridike dhe psikologjike falas gjatë çdo procesi administrativ dhe ligjor që përfshin fëmijët⁵⁹; **masa bashkërenduese** ndërmjet një sërë institucioneve dhe krijimi i grupit teknik ndërsektorial në çdo njësi që ka mbi 3000 fëmijë⁶⁰; vendosja e linjave telefonike ndihmëse për fëmijët⁶¹; **detyrimi për raportim për çdo person** që ka informacion për abuzim të fëmijës, çdo person që punon në kontakt me fëmijët përfshirë, detyrimin e posaçëm të raportimit për mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psiko-social⁶², **masat mbrojtëse** të tilla si: masat e përkujdesjes alternative⁶³ si shpërngulja dhe vendosja e fëmijës në familjen të afërmeve të tij, në një familje kujdestare ose në një institucion të përkujdesit për fëmijët, për një periudhë të shkurtër kohe, sipas parimit se i jepet përparësi vendosjes së fëmijës në një mjedis familjar; masa emergjente të mbrojtjes⁶⁴ si largimi i fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative; masat për mbikëqyrje të specializuara të fëmijës brenda mjedisit familjar⁶⁵; hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes për çdo fëmijë, i cili përmban një sërë masash të përgjithshme për fëmijën, përfshirë masat për ndërhyrje dhe hetim të menjëhershëm, masat e kujdesit shëndetësor, mbështetje psikologjike dhe juridike, mbështetje sociale dhe çdo shërbim tjetër të nevojshëm për rehabilitimin dhe ri-integrimin e fëmijës së abuzuar.

Konstatime: Pavarësisht përpjekjeve në përputhje me rregullimet ligjore të sipërcituara, nisur nga monitorimet dhe hetimet e trajtimeve të rasteve të fëmijëve për mbrojtje nga NJMF në përgjithësi, AP konstaton, se administrimi në praktikë i menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në vendin tonë dhe vështirësitë e hasura në praktikë për menaxhimin e këtyre rasteve sidomos të fëmijëve viktimë të abuzimit seksual tejkalojnë parashikueshmërinë e reflektuar

⁵⁶Neni 14 (1), i Konventës së Lanzarotës

⁵⁷ Neni 14 (2), i Konventës së Lanzarotës

⁵⁸Neni 14 (3), i Konventës së Lanzarotës

⁵⁹ Neni 29 (1),

⁶⁰ Neni 52 (1)

⁶¹ Neni 68,

⁶² Neni 67 (1), (2), (3) and (4), Ibid

⁶³ Neni 31 (1) and (2), Ibid.

⁶⁴ Neni 55 (1) (a), Ibid.

⁶⁵ Neni 55 (1) (c), Ibid.

në masat e sipërcituara. Kjo, pasi mundësitë (buxhetet, kapacitetet e burimeve njerëzore, shërbimet sociale etj) që bashkë dhe njësitë administrative janë të ndryshme për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore fillimisht, i kushtojnë rëndësi plotësimin të nevojave bazë jetike. Përveç, plotësimin të kuadrit rregullator dhe të adaptuar, AP vlerëson nevojën për trajnimin e strukturave të mbrojtjes së fëmijës për të punuar me fëmijët e abuzuar seksualisht. Nga ana e PMF janë marrë masat për t'ju përgjigjur me sa mundeshin rasteve të abuzimit apo shfrytëzimit seksual, por konstatojmë se ju mungon informacioni dhe trajnimi, se si të adresonin në mënyrën e duhur situatat e fëmijëve të abuzuar seksualisht. Pothuajse nga të gjitha rastet e trajtuara nga AP të bëra publike në mediat online, këto struktura PMF/NJMF janë mbështetur nga ASHDMF.

Masat gjatë procesit të ndjekjes penale përfshijnë hetimin penal dhe proceset gjyqësore të rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve, të parashikuara në kreun VII të Konventës së Lanzarotës. Konventa parashikon, se hetimet dhe proceset penale duhet të kryhen në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës⁶⁶, me një qasje mbrojtjeje ndaj viktimave, në mënyrë që të garantohet, se hetimi penal dhe procesi gjyqësor nuk e përkeqësojnë traumën që kalon fëmija⁶⁷. Konkretisht, standardet që duhen ndjekur janë:

- **njësitë përgjegjëse për hetimet** duhet të përbëhen nga nëpunës të trajnuar për të trajtuar rastet e fëmijëve të abuzuar⁶⁸;
- **intervistat** me fëmijët duhet të zhvillohen nga nëpunës të trajnuar, në mjedis të përshtatshme, kur është e mundur nga i njëjti person/nëpunës dhe të jenë në një numër të kufizuar, me qëllim që fëmija mos të duhet të përjetojë vazhdimisht të njëjtën eksperiencë traumatike⁶⁹;
- gjatë procesit gjyqësor, gjyqtari të mund të urdhërojë që **seanca të jetë e mbyllur** dhe viktimat të dëgjohet **pa qenë i/e pranishme** në sallën e gjyqit, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të komunikimit⁷⁰;
- **standardet e hetimit dhe ndjekjes penale** për trajtimin e këtyre rasteve duhet të jenë **përparësi**, për sa i përket hetimit dhe procedimit penal⁷¹;
- sigurimin e hetimeve dhe ndjekjes penale efektive, **duke lejuar operacionet e fshehta**⁷²;
- fillimin e hetimeve **kryesisht (ex officio)** të këtyre veprave penale, pa nevojën e një raportimi ose akuze të ngritur nga viktimat⁷³;

⁶⁶ Neni 30 (1) i Konventës së Lanzarotës

⁶⁷ Neni 30 (2) të Konvetës së Lazarotës

⁶⁸Neni 34 (1) i Konventës së Lanzarotës

⁶⁹Neni 35 (1) i Konventës së Lanzarotës

⁷⁰Neni 36 (1) i Konventës së Lanzarotës

⁷¹Neni 30 (3) i Konventës së Lanzarotës

⁷²Neni 30 (5) i Konventës së Lanzarotës

⁷³Neni 32, i Konventës së Lanzarotës

- **vazhdimin e proceseve penale** edhe në rast se viktimat e tërheq deklarimet e tyre/saj⁷⁴;
- caktimi i një afati të mjaftueshëm për parashkrimin e veprës penale, që nis pasi viktimat të ketë arritur moshën madhore⁷⁵.

Përfundimet: Avokati i Popullit lidhur me masat gjatë procesit të ndjekjes penale të hetimit penal dhe proceset gjyqësore të rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve, vlerëson zhvillimin e rëndësishëm në legjislacionin shqiptar me miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit (KDPM-së)⁷⁶. Ky kod parashikon një sërë normash që rregullojnë pozitën e fëmijëve brenda sektorit të drejtësisë penale dhe miraton rregulla dhe procedura specifike të nevojshme për trajtimin e kësaj kategorie të brishtë. KDPM-ja kryesisht ka si qëllim rregullimin e aspekteve të përgjegjësisë penale të fëmijëve që kryejnë vepra penale, por përmban gjithashtu dispozita të rëndësishme në lidhje me fëmijët viktimat të krimeve, përfshirë edhe abuzimin seksual. Në fakt, KDPM-ja rregullon çështje të tilla si: pozita e fëmijës viktimë gjatë hetimit dhe ndjekjes penale; intervistat me fëmijët; masat mbrojtëse gjatë gjithë procesit, në mënyrë që të mos përkeqësohet trauma e tyre; mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve viktimat dhe çështje të ngjashme. Pra, të gjitha aspektet, të cilat janë përmendur dhe janë nxitur të rregullohen nga disa prej instrumenteve ndërkombëtare të shpjeguara në paragrafet e mësipërme.

Standardet ndërkombëtare të harmonizuara në dispozitat kryesore të KDPM-së që zbatohen për fëmijët viktimat të abuzimit seksual janë:

Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi: parashikon parimin se çdo organ kompetent duhet të shqyrtojë në mënyrë të shpejtë dhe me përparësi çështjet me të mitur viktimat, duke garantuar që procesi penal, në çdo fazë të tij, të mos përkeqësojë traumën e përjetuar⁷⁷. Duhet të përmendet se me autoritete kompetente⁷⁸, përfshihen të gjithë punonjësit të cilët vendosen në kontakt me fëmijën, viktimën, përfshirë gjyqtarin, prokurorin, punonjësin e policisë gjyqësore, punonjësin e policisë së shtetit, avokatin, psikologun, punonjësin social, punonjësin e Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (**Neni 17**).

Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut: parashikon se në mënyrë që të mbrohen fëmijët nga trauma, prania e psikologut është e detyrueshme në të gjitha procedurat e ndjekjes penale (hetimi dhe gjykimi). Prania e psikologut është gjithashtu e nevojshme për të siguruar që intervistat me fëmijët të zhvillohen në

⁷⁴Neni 32 i Konventës së Lanzarotës

⁷⁵Neni 33, i Konventës së Lanzarotës

⁷⁶ Ligji nr. 37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”.

⁷⁷ Neni 17 (2), Ibid.

⁷⁸ Neni 3 (15), Ibid.

mënyrën e duhur. Përveç kësaj parashikohet se kur është e mundur, i njëjti psikolog të ndjekë të njëjtin fëmijë viktimë përgjatë gjithë procesit. (Neni 18).

Ndihma ligjore dhe psikologjike e të miturit (falas): parashikon se në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur, çdo i mitur viktimë ka të drejtë për ndihmë ligjore dhe psikologjike, pa pagesë, të garantuar nga shteti, sipas legjislacionit përkatës. (Neni 20)

Mbrojtja e jetës private të të miturit: parashikon se në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur privatësia e fëmijëve duhet të respektohet dhe çdo informacion që mund të çojë në identifikimin e fëmijës viktimë nuk lejohet të publikohet. (Neni 21)

Mbi trajnimin dhe specializimin e autoriteteve kompetente: parashikohet se organet kompetente që punojnë me të miturit duhet të kenë ekspertizën e nevojshme⁷⁹ dhe se personat që administrojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur duhet të jenë të specializuar dhe të trajnuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve⁸⁰. Ky detyrim përfshin shumë punonjës dhe profesionistë të tillë si prokurorin, punonjës të policisë gjyqësore, punonjës të policisë së shtetit, avokatin, psikologun, punonjës social, punonjës të njësive për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, etj. (Nenet 25-29-30-31-32)

Specializimi i personave që administrojnë dhe asistojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur: parashikon ndër të tjera, kufizime të personave që punojnë me të miturit dhe përkatësisht në paragrafin 2 përcakton se organet kompetente sigurojnë që çdo person që ka qenë i dënues me një vendim të formës së prerë për një vepër penale të kryer me dashje ndaj të miturit ose për dhunë në familje, ndalohet të punojë me të miturin. (Neni 25)

Kompetenca e gjykimit të çështjeve të drejtësisë për të miturit: parashikon se brenda gjykatave të rretheve gjyqësore krijohen seksione të posaçme për çështjet e të miturve. Këto seksione janë kompetente edhe për gjykimin e të pandehurve të rritur që akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve/fëmijëve (Neni 27).

Masat mbrojtëse për të miturin viktimë ose dëshmitar: parashikon se në çdo fazë të procesit penal duhet të merren masa të veçanta mbrojtëse për fëmijën viktimë kur siguria e fëmijës është në rrezik. Në varësi të rrethanave këto masa miratohen kryesisht nga gjyqtari (*ex-officio*), nga prokurori, nga policia gjyqësore ose Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Masat mbrojtëse konsistojnë

⁷⁹ Neni 25 (1), i KDMP-së

⁸⁰ Neni 25 (4), Ibid.

në shmangien e kontaktit të drejtpërdrejtë midis të miturit viktimë dhe të akuzuarit, në çdo fazë të procesit; bërjen e kërkesës për nxjerrjen e një “urdhri-kufizimi” në gjykatë; bërjen e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit “arrest me burg” për të akuzuarin; mbrojtjen e fëmijës prej policisë; masa të tjera të përshtatshme (**Neni 37**).

Konventa e Lanzarotës solli risi, në vendosjen e detyrimit për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave nga shtetet palë, duke e konsideruar si mjet i domosdoshëm dhe i nevojshëm për luftën kundër abuzimit seksual tek fëmijët. Nga palët e konventës kërkohet që të mbledhin dhe të ruajnë të dhënat që lidhen me identitetin dhe me profilin gjenetik (ADN) të personave të dënuar për abuzim seksual të fëmijëve⁸¹. Këto të dhëna duhen të kontrollohen nga një autoritet i vetëm kombëtar, i cili duhet të themelohet nga çdo shtet palë dhe t’i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të KE-së.

Konstatime: Avokati i Popullit sjell në vëmendje, se standartet e sipërcitura gjatë procesit të ndjekjes penale të hetimit penal dhe proceset gjyqësore të rasteve të abuzimit seksual të fëmijës lidhur me legjislacionin shqiptar në tërësi janë të fragmentuara dhe mungojnë përkufizime shumë të rëndësishme lidhur me abuzimin seksual të fëmijës, angazhimin dhe detyrimin e tyre në aktivitete seksuale dhe në aktivitete të tjera të pahijshme. Gjithashtu, në Kodin Penal është parashikuar dhe mosha e pëlqimit seksual, 14 vjeç, e cila nuk është në përputhje me standartet e Konventës së Lanzarotës. Një informacion më të detajuar për të shmangur përsëritjen e këtyre konstatimeve lidhur me harmonizimin e legjislacionit të brendshëm penal me standartet ndërkombëtare, do ta pasqyrojmë në kreun e fundit, gjetjet dhe përfundimet.

1.3. Instrumentat evropiane për luftimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve

Miratimi i Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore (*Karta e BE-së*), solli një qasje të re të drejtave të njeriut brenda legjislacionit të Bashkimit Evropian. Fillimi i punës për miratimin e Kartës së BE-së e ka pikënisjen në vitin 2007, pas shpalljes në Këshillin Evropian të Nicës, më 7 dhjetor 2000 dhe hyri në fuqi, si Traktati i Lisbonës, më 1 dhjetor 2009. Në këtë moment, Karta e BE-së ka vlerë ligjore detyruese, parashikuar në pikën 1, të nenit 6, të Traktatit të Bashkimit Evropian. Tash, ajo ka vlerë të njëjtë ligjore me vetë Traktatet e BE-së⁸². Të drejtat e njeriut të përfshira dhe të njohura në Kartën e BE-së janë të detyrueshme, si për institucionet dhe organet e BE-së, ashtu edhe për autoritetet kombëtare të shteteve anëtare të BE-së, gjatë zbatimit të së drejtës evropiane.

⁸¹Neni 37, i Konventës së Lanzarotës

⁸² ec.europa.eu/justice/fundamental-rights/charter/index_en.htm

Në Kartën e BE-së të drejtat e fëmijës janë parashikuar në një dispozitë të posaçme, në nenin 24, i cili parasheh parimet e **mbrojtjes dhe kujdesit të fëmijëve dhe mirëqenies së tyre**⁸³ dhe marrjen në konsideratë të **interesit më të lartë të fëmijës**⁸⁴ nga të gjitha institucionet publike ose private. Por, BE-ja nuk është mjaftuar vetëm me përfshirjen e të drejtave të fëmijëve në Kartën e BE-së. Ajo ka shfrytëzuar një nga funksionet e saj legjislativive specifike, atë të miratimit të legjislacionit të detyrueshëm në fushën shumë delikate të legjislacionit penal duke miratuar një direktivë, që rregullon abuzimin seksual të fëmijëve⁸⁵. Kjo direktivë përfshin rregullat minimale për përcaktimin e veprave penale dhe sanksioneve në fushën e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe dispozitat për të forcuar parandalimin e krimeve seksuale ndaj fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre.

Ajo ka ngjashmëri me Konventën e Lanzarotës, në të cilën përcaktohen masat parandaluese, mbrojtëse, ndihmëse, mbështetëse dhe, masa të ndjekjes penale me parime të zbatueshme në rastet e abuzimit seksual të fëmijëve. Gjithashtu, në të njëjtën linjë me konventën, Direktiva 2011/92, përfshin masën kufizuese, element efektiv, e cila parashikon masën e përjashtimit të përkohshëm ose të përhershëm të personave të dënuar për vepra penale, që lidhen me abuzimin seksual dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve, nga aktivitetet që përfshijnë kontakte të drejtpërdrejta dhe të rregullta me fëmijët⁸⁶. Kjo masë përfshin mundësinë e punëdhënësve, për të kërkuar dhe marrë nga personat, të cilët aplikojnë për vende pune në kontakt të drejtpërdrejtë dhe të rregullt me fëmijët, dëshminë e penalitetit për ekzistencën e këtyre lloj veprave penale kundër fëmijëve⁸⁷.

Ndryshe nga Konventa e Lanzarotës, Direktiva 2011/92 përcakton dispozitat materiale të ligjit penal, si dhe direktivat përkatëse për afatet minimale të burgimit për çdo vepër penale. (p.sh., në pikën 2, të nenit 3, parashikohet, se dënimi minimal është një viti burgim, në rastet kur një fëmijë detyrohet të jetë dëshmitar gjatë kryerjes së marrëdhënieve seksuale).

Konstatime: Dispozitat materiale të ligjit penal shqiptar lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve përfshihen dhe përcaktohen në Kodin Penal Shqiptar. Avokati i Popullit si vërejtje të përgjithshme thekson, se KP-ja parashikon dënime të larta për veprat penale të abuzimit seksual, duke parashikuar në dënime me burgim

⁸³ Neni 24 (1) i Kartës së BE-së

⁸⁴ Neni 24 (2), I Kartës së BE-së

⁸⁵ Direktiva 2011/92/EU e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, e datës 13 dhjetor 2011 “Për luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve...”

⁸⁶ Neni 10 (1), Direktiva 2011/92/EU e e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të datës 13 dhjetor 2011 “për luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve dhe zëvendësimin e vendimit të Këshillit 2004/68/JHA”

⁸⁷ Neni 10 (2) Direktiva 2011/92/EU e e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të datës 13 dhjetor 2011 “për luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve dhe zëvendësimin e vendimit të Këshillit 2004/68/JHA”

shumëvjeçar. Të paktën disa prej këtyre veprave penale parashikojnë dënime mjaft më të larta se dënimet minimale të parashikuara për vepra penale të ngjashme nga Direktiva 2011/92 /BE. Tre janë nenet të cilat trajtojnë në mënyrë të posaçme abuzimin seksual të fëmijëve, Neni 100, Neni 101 dhe Neni 108. Nenet e tjera, që rregullojnë aspekte të ndryshme të abuzimit seksual, janë klauzola të përgjithshme, të cilat përfshijnë veprime të dënueshme kundër fëmijëve si një rrethanë rënduese.


Së fundmi, është e rëndësishme të theksojmë ekzistencën e direktivës së BE-së mbi këtë çështje, për detyrimin që kanë shtetet anëtare të BE-së për të transpozuar në legjislacionin e tyre të brendshëm rregullat minimale penale të miratuara nga Direktiva 2011/92, si dhe masat parandaluese, mbrojtëse, ndihmëse, mbështetëse, masat e ndjekjes penale dhe parimet e direktivës. Vetë karakteristikat e direktivës së bashku me faktin, se mekanizmat e monitorimit dhe kontrollit në kuadrin e BE-së janë më të forta dhe kanë impakt më të madh, se çdo akt tjetër që rrjedh nga legjislacioni ndërkombëtar, e bën Direktivën 2011/92 një pjesë themelore të legjislacionit ndërkombëtar mbi mbrojtjen e fëmijëve kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual.

PANORAMË E PËRGJITHSHME MBI SITUATËN E ABUZIMIT SEKSUAL NDAJ FËMIJËVE NË SHQIPËRI

Shqipëria konsiderohet si një nga vendet me popullsinë më të re në Europë dhe fëmijët përbëjnë një grup të rëndësishëm të popullsisë. Të dhënat e Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) theksojnë, se rreth 30% e popullsisë së vendit janë nën moshën 18 vjeç.

Bazuar tek Censusi i vitit 2011, lidhur me të dhënat sasisore dhe cilësore të fëmijëve konstatojmë, se fëmijët përbëjnë 30% (847.312) të popullatës së përgjithshme. Fëmijët 0-4 vjeç përbëjnë 5.8% (163.493); fëmijët 5-9 vjeç janë 6.4% (181.697); fëmijët 10-14 vjeç përbëjnë 8.3% (233.376) dhe ata 15-19 vjeç përbëjnë afërsisht 10% (268.746) të popullsisë totale, sikurse paraqitet në grafikun si vijon:

Grafiku 1. Shpërndarja e fëmijëve sipas grup-moshave, gjinisë, totalit sipas Census 2011



Nga të dhënat e mësipërme, konstatojmë ndryshimin e ndodhur, ndërmjet popullatës urbane dhe rurale në vendin tonë, ku popullsia urbane në Census e 2011 është më e madhe se popullsia rurale, krahasur me Census 2001. Bazuar, në këto të dhëna, popullsia banuese në zonat urbane ishte 53.5%, ndërsa 46.5% popullsisë jetonin në zonat rurale.

Pavarësisht këtij elementi pozitiv, përqindja e popullatës rurale është e lartë (46%). Një ndër tiparet dalluese të popullatës rurale në tërësi janë kushtet e vështira social-ekonomike të këtyre familjeve, e cila ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e fëmijës dhe aksesit të fëmijës në shërbimet publike, të tilla, si: arsim, shëndetësi, shërbime sociale, e për rrjedhojë edhe në aktivitetet informuese dhe sensibilizuese.

Gjithashtu, nga totali i popullatës së përgjithshme, 11.859 fëmijë të moshës 15-19 vjeç (268.746 të numrit total të fëmijëve), ishin të martuar në atë kohë, nga të cilët 2.557 ishin meshkuj dhe 9.302 ishin femra.

Ndërsa, shkalla e analfabetizimit për popullatën është 2.8% mes popullsisë mbi 10 vjeç. Gjysma e analfabetëve janë 75 vjeç ose më shumë. Norma e analfabetizimit është gjithashtu më e lartë mes grave (3.7%) dhe burrave (1.7%). Sipas të dhënave të censusit, 14.9% e popullsisë analfabete ka arsim fillor si niveli më i lartë i arsimit të arritur, 40.9% ka arsim tetëvjeçar dhe 26.4% ka arsim të mesëm, përfshirë arsimin e përgjithshëm ose profesional. Përqindja e popullsisë që ka mbaruar studime universitare ose është aktualisht në universitet, ose në studime pasuniversitare është 10.7% e popullsisë (ose 262,369 persona). Ndërsa,

dhjetë vjet më parë, sipas censusit 2001, njerëzit në universitet ose që kishin mbaruar universitetin përbënin 5.5% të popullsisë.

Elementët e sipërpërmendur janë domethënës për përdorimin dhe përfshirjen e tyre në hartimin e një programi specifik, “*data-baze*” kombëtare të të dhënave të koordinuara lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve, i cili do të ndihmonte politikbërësit në njohjen e thelluar të fenomenit dhe parandalimin e tij.

Bazuar në legjislacionin e brendshëm, konkretisht në ligjin nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”⁸⁸ parashikohet detyrimi periodik për mbledhjen e të dhënave statistikore (që kanë përpunuar për fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësive administrative përkatëse), që Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës kanë për të raportuar pranë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF). Për vitin 2019-2020, nga informacioni i përpunuar për punën e 241 PMF-ve në 61 bashkitë e vendit nga ASHDMF,⁸⁹ për fenomenin e abuzimit seksual janë pasqyruar këto të dhëna sasiore dhe cilësore.

Më konkretisht, NJMF kanë raportuar ndjekjen e **29 rasteve të dhunës seksuale ndaj fëmijëve në vitin 2019 dhe 65 raste të abuzimit seksual në vitin 2020**. Krime të tilla janë kryer nga persona të njohur apo familjarë pra, kryesisht brenda rrethit të besimit. Ka dhe raste, kur vajza adoleshente kanë pranuar të lidhen me persona më të rritur, të cilët më pas kanë abuzuar seksualisht me to.

Përfundimet: Statistikat e lartpërmendura tregojnë rritjen e numrit të raportimeve të fëmijëve të abuzuar dhe shfrytëzuar seksualisht. Faktorët që mund të analizohen janë të shumtë të tillë; si impakti i mediave vizive dhe online (zhvillimi i teknologjisë së informacionit është më afër fëmijëve), përmirësimi dhe fuqizimi i legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, ngritja dhe funksionimi i mekanizmave të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve.

Konkluzionet: Avokati i Popullit shpreh shqetësimin se këto të dhëna nuk janë të mjaftueshme, pasi nuk pasqyrojnë dhe mundësojnë kryqëzimin e informacionit ndërmjet strukturave të mbrojtjes në nivel vendor (PMF/NJMF) dhe të dhënave të strukturave në nivel qendror, siç e parasheh në mënyrë eksplicite ligji nr. 18/2017 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Ndërkohë, mungesa e regjistrave të unifikuar midis Policisë, Prokurorisë dhe Gjykatës përse i përket raportimeve të krimeve seksuale dhe të dhënave mbi viktimat e abuzuesit dhe përfshirja e tyre në Regjistrin Kombëtar Elektronik Kombëtar për Rastet e Fëmijëve në Nevojë për Mbrojtje, passjell fragmentizimin e të dhënave duke penguar analizën reale të faktorëve që ndikojnë rritjen e numrit të abuzimit të fëmijëve, si dhe nuk janë

⁸⁸ Në zbatim të shkronjës “ç”, të nenit 49, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

⁸⁹ Të dhënat e punës së Njësive për Mbrojtjen e Fëmijës, për vitin 2018, raporti vjetor i ASHDMF

të mjaftueshme për të vlerësuar dukurinë e abuzimit apo shfrytëzimit seksual tek të miturit në vendin tonë. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të sistemit të integruar të mbrojtjes sociale, ku përfshihet policia, prokuroria, gjykata etj, në nivel kombëtar, ndihmon në realizimin e studimeve të mirëfillta për hartimin e politikave efektive, lidhur me parandalimin e këtij fenomeni dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës seksuale.

Ekzistojnë shumë pak studime për dukurinë e abuzimit seksual tek fëmijët, përveç disa raportimeve të organizatave ndërkombëtare dhe kombëtare të shoqërisë civile, që trajtojnë çështjen e dhunës ndaj fëmijëve në përgjithësi, por shumë pak ka të dhëna ka për abuzimin apo shfrytëzimin seksual ndaj fëmijëve.

Për efekt të studimit dhe analizimit të shkaqeve të dukurisë, pasqyrimi i të dhënave statistikore dhe cilësore të prodhuara nga disa organizata të shoqërisë civile, prezanton në të njëjtën kohë një përmbledhje dhe një evidencë sintetike të të dhënave konkrete ekzistuese në vendin tonë.

- ✚ Për herë të parë në vitin 2006, Qendra e Zhvillimit Human me mbështetjen e UNICEF-it publikoi raportin “Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri”. Ky studim trajtoi gjerësisht fenomenin e dhunës dhe formave të saj tek fëmijët në Shqipëri. Në këtë studim lidhur me abuzimin seksual, përveç rasteve të fenomenit të përdhunimit nga persona të panjohur, u konstatuan edhe rastet e abuzimit seksual. Kampioni i përzgjedhur për realizimin e këtij studimi ishte 1.500 fëmijë, ku çdo një në dy fëmijë në shtëpi dhe çdo një në tre fëmijë në shkollë, pranuan se dhuna ndaj tyre ishte e justifikueshme. Nga numri total i fëmijëve rezulton, se 13.3% e tyre ngacmoheshin seksualisht dhe, shkolla është një mjedis në të cilin mund të ndodhë abuzimi seksual. Po kështu, sipas këtij studimi, një në pesë ngacmues seksualë të fëmijëve (22.5%) janë mësues. Tërheq vëmendjen fakti, që ngacmimi seksual i raportuar nga fëmijët në sistemin e përkujdesjes shoqërore (prej 15%), ishte më i lartë se në mjedise të tjera. Në këtë studim, fëmijët e sistemit të përkujdesjes shoqërore raportuan autorësinë e ngacmimeve seksuale si vijon: 55.6% nga fëmijët e tjerë, 22.2% nga mësuesit dhe 22.3% nga persona të tjerë. Në studim janë pasqyruar edhe raste të incestit nga babai, xhaxhai ose vëllai. Sipas fëmijëve, **rreziqet nga përdhunimet vijnë nga njerëzit e shtëpisë, nga mësuesit meshkuj pas orës së zakonshme të mësimit, nga djemtë e lagjes, nga nxënësit më të rritur ndaj vajzave më të vogla, nga rojet e pallateve ose nga të panjohur.** Reagimet e familjeve ndaj vajzave të përdhunuara, në këtë studim tregojnë se **disa familje i largojnë vajzat nga shkollat e mëparshme dhe i dërgojnë në shkolla të tjera.** Prindërit duket se vepronin kështu, për t'i mbrojtur vajzat

nga përdhunimet e tjera, si dhe për t'u mbrojtur nga stigmatizimi i opinionit.

✚ Në vitin 2012, në Shqipëri është realizuar studimi mbi “Prevalencën e përvojave negative gjatë fëmijërisë” (Community Survey on Prevalence of Adverse Childhood Experiences in Albania - ACE survey)⁹⁰. Ky studim pasqyron përvojat negative gjatë fëmijërisë mbi abuzimin seksual gjatë fëmijërisë të të rinjve shqiptarë. Kampioni i përzgjedhur për realizimin e këtij studimi ishin 1437 studentë, nga të cilët 67.6% femra dhe 32.4% meshkuj. Rezultatet pasqyrojnë një prevalencë të lartë të keqtrajtimit të fëmijëve, ku format më të shpeshta të abuzimit gjatë fëmijërisë ishin ato fizike (40%), psikologjike (50%), seksuale (6%), dhe të qenurit dëshmitarë të keqtrajtimit të nënës (rreth 30%), duke paraqitur nivelin më të lartë të keqtrajtimit në këtë popullsi krahasuar me 8 vendet e tjera që kanë kryer studimin ACE-së. Rreth 14% e studentëve raportuan të paktën njëherë prej përvojave negative gjatë fëmijërisë (PNF) dhe, pothuajse gjysma e tyre raportuan dy ose më shumë PNF. Gjetjet e këtij studimi tregojnë, se djemtë raportuan më shumë abuzim seksual në krahasim me vajzat gjatë periudhës së fëmijërisë së tyre (8.8% djemtë dhe 4.7% vajzat). **Pirja e duhanit, abuzimi me drogën dhe alkoolin** ishin të gjitha të lidhura pozitivisht me të qenit dëshmitar dhe përjetimin e abuzimit fizik, emocional dhe seksual. Studentët me **vendbanim dhe origjinë nga zonat rurale, me nivel të ulët arsimimi** të prindërve, me status papunësie të babait dhe nivel të ulët të të ardhurave, ishin në mënyrë domethënëse të prirur për të qenë dëshmitarë apo për të përjetuar abuzim fizik, nëpërkëmbje apo grindje. Gjithashtu, viktimat e abuzimit seksual ishin 11 herë më të prirura drejt përpjekjeve për vetëvrasje dhe tre herë më të prirura për të patur një shtatëzani të padëshiruar.

✚ Në vitin 2013, në Shqipëri u realizua “Studimi Epidemiologjik Ballkanik mbi Abuzimin dhe Neglizhimin e Fëmijëve” (Balkan Epidemiologic Study on Child Abuse and Neglect, BECAN⁹¹). Ky studim epidemiologjik në Ballkan mbi abuzimin dhe neglizhimin e Fëmijëve (B.E.C.A.N) u krye në 9 vende ballkanike (Shqipëri, Bosnje & Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Maqedoni, Greqi, Rumani dhe Turqi). Qëllimi i tij konsistonte në identifikimin e numrit të rasteve të raportuara dhe zbuluara të abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve (grup-mosha 11-16 vjeç). Studimi u fokusua në identifikimin e prevalencës dhe incidencës së dhunës ndaj fëmijëve përsa i takon llojeve: dhunë psikologjike, dhunë fizike, ngacmim seksual, abuzim seksual, dhe neglizhim i fëmijëve. Kampioni i përzgjedhur për realizimin e këtij studimi BECAN në Shqipëri u zhvillua tek 3.328 fëmijë (54 % vajza

⁹⁰ https://www.euro.who.int/data/assets/pdf_file/0016/181042/e96750.pdf

⁹¹ <https://cordis.europa.eu/project/id/223478/reporting>

dhe 46% djem). Rezultatet treguan, se prevalenca e abuzimit psikologjik ishte 69% dhe incidenca 62%. Lidhur me përhapjen e abuzimit fizik rezultoi, se prevalenca ishte 59%, ndërsa incidenca 48%. Prevalenca e ngacmimeve seksuale ishte 11%, ndërsa incidenca ishte 9%. Prevalenca e dhunës seksuale u raportua në 4.9% dhe incidenca 4%. Të dhënat e disagreguara sipas gjinisë treguan, se vajzat raportonin shifra më të larta të abuzimit (prevalenca 70%/incidenca 63%), krahasuar me djemtë (prevalenca 67%/incidenca 60%), (20). Nga ana tjetër, 93% e fëmijëve raportuan të mos kishin qenë asnjëherë viktimë të abuzimit seksual. Grupimi i të gjitha formave të abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve nuk rezultoi në ndryshime sinjifikative sipas grupmoshës së fëmijëve. Në tërësi, ky studim zbuloi se të gjitha format e dhunës janë të pranishme tek fëmijët e vendit tonë, pavarësisht se magnituda e saktë është shumë e vështirë për t'u raportuar.

Në qershor 2021, UNICEF publikoi studimin “Analiza e Situatës së Fëmijëve dhe Adoloshentëve në Shqipëri”⁹². Analiza paraqet një analizë të pavarur të situatës së fëmijëve dhe adoloshentëve dhe të drejtave të tyre në Shqipëri. Ky studim, mund të përdoret nga të gjitha palët e interesit në vendin tonë, për të identifikuar dhe adresuar pengesat dhe mundësitë për realizimin e plotë të çdo të drejte të çdo fëmije. Një ndër të drejtat themelore të fëmijëve është e drejta për mbrojtje nga çdo formë e dhunës, në të cilën përfshihet edhe e drejta e mbrojtjes së fëmijës nga abuzimi seksual. Në këtë studim, theksohet, se në vendin tonë nuk ka studime të mjaftueshme përse i përket mbrojtjes së fëmijës dhe nevojitet të kryhen studime të veçanta lidhur me dhunën ndaj fëmijëve në shtëpi, në shkollë dhe institucione të tjera. Akoma, në vendin tonë nuk ka informacion të mjaftueshëm rreth shkallës ose prevalencës së abuzimit seksual të fëmijëve, punës së fëmijëve dhe shfrytëzimit të tyre⁹³.

Të dhënat e pasqyruara për dhunën të prezantuar në këtë raport janë si vijon:

Studimi Demografik dhe Shëndetësor (SDSH) në Shqipëri 2018⁹⁴ nxori në pah se 37 për qind e fëmijëve ishin disiplinuar vetëm nëpërmjet mënyrave jo të dhunshme, duke përfshirë heqjen e privilegjeve ose duke i dhënë fëmijës diçka tjetër për të bërë, pa përdorur dhunë verbale ose fizike. Rreth 42 për qind kishin përjetuar agresion psikologjik (p.sh. bërtitje), dhe 32 për qind kishin përjetuar një formë të agresionit fizik. Anketa e Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave (DHNGV-së) konstatoi, se 47,7 për qind e grave, që kishin përjetuar dhunë në familje, kishin fëmijë të moshës 0-17 vjeç që jetonin në shtëpi bashkë me to dhe **bazuar në**

⁹² Analiza e Situatës së Fëmijëve dhe Adoloshentëve në Shqipëri, UNICEF, qershor 2021

⁹³ Fq 51, e drejta për mbrojtje, mjedis familjar dhe kujdes alternative, Analiza e Situatës së Fëmijëve dhe Adoloshentëve në Shqipëri, UNICEF, qershor 2021

⁹⁴ ADHS, 2018, puna e cituar f.137

kampionin e përfshirë në anketë, u vlerësua se 286,498 fëmijë të kësaj moshe ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje gjatë jetës së tyre (të paktën një herë) dhe, se 246,707 ishin të ekspozuar aktualisht ndaj dhunës në familje. Fëmijët e moshës 5 -17 vjeç të ekspozuar ndaj dhunës në familje në dymbëdhjetë muajt e kaluar kishin dy herë më shumë gjasa të kishin makthe të shpeshta (25,3%) sesa fëmijët e tjerë (9,5%), tre herë më shumë gjasa të lagnin shpesh shtratin (20,4%), të ishin të ndrojtur ose të tërhequr (21,5%), dhe të silleshin në mënyrë agresive me nënën e tyre ose fëmijët e tjerë, ose të dyja së bashku (6,9%). Të dhënat administrative të policisë të vitit 2017 tregojnë, se 61 për qind (70 fëmijë) e të gjitha rasteve të abuzimit seksual në Shqipëri janë kryer ndaj fëmijëve.⁹⁵ Dhuna seksuale është një shqetësim i veçantë për vajzat dhe gratë, si dhe fëmijët pa kujdes prindëror, ku 3,1 për qind e grave të moshës 18 - 74 vjeç⁹⁶ raportuan se ishin abuzuar seksualisht gjatë fëmijërisë⁹⁷. Disa raste të fëmijëve të abuzuar seksualisht në mënyrë sistematike në komunitetin e tyre dhe në qendrat rezidenciale të kujdesit u bënë të njohura për publikun në vitin 2020 dhe 2021. Trajtimi i rasteve nxori në pah mungesën e profesionistëve të specializuar dhe shërbimeve të integruara që mund të ishin në shërbim të interesit më të mirë të fëmijëve. Aktualisht, qeveria ka krijuar një grup pune *ad hoc* të nivelit të lartë të drejtuar nga kryeministri për të trajtuar dhe parandaluar dhunën ndaj fëmijëve, me fokus të veçantë në dhunën seksuale. Shkolla është një element tepër i rëndësishëm i mjedisit mbrojtës për fëmijët dhe në sondazhin e SSHFMSH -së të vitit 2018, rreth 22 për qind e fëmijëve raportuan se kishin përjetuar të paktën një rast bullizimi në shkollë, ku mbizotëronin më shumë djemtë sesa vajzat (përkatësisht 24% dhe 20%). **Këto nuk janë shifra të papërfillshme dhe tregojnë se kërkohet të njihet më mirë fenomeni i dhunës në shkolla. Mbi të gjitha nevojitet një politikë e dedikuar dhe e qartë për të identifikuar dhe trajtuar rastet e dhunës në mjediset shkollore.**

Qendra Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijës nga Dhuna Seksuale (CRCA/ESPA) BARNAHUS është shërbim komunitar me qasje multidisiplinare për fëmijët e dhunuar seksualisht, e cila ofrohet nga organizatat jofitimprurëse e licensuar nga shteti për të ofruar shërbime të tilla të specializuara në nivel komunitar dhe kombëtar, ndërkohë që ka një eksperiencë prej 25 vitesh të shërbimeve në mbrojtje të fëmijëve dhe të rinjve.

Bazuar në databazën e rasteve të BARNAHUS-Shqipëri për periudhën 2019-2021, numri i fëmijëve të trajtuar është si më poshtë

⁹⁵ INSTAT, 2018, Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale 2016-2017, i disponueshëm në: <http://www.instat.gov.al/media/4824/crime-and-criminal-justice-statistics.pdf>

⁹⁶ DHNGV, 2019, puna e cituar.


⁹⁷ ishin prekur seksualisht pa dëshirën e tyre ose ishin detyruar të kryenin një akt seksual pa dëshirën e tyre’.

| | | | |
|-------|------|------|------|
| Viti | 2019 | 2020 | 2021 |
| numri | 12 | 23 | 15 |

Qendra ka realizuar dhe profilin e viktimave të dhunës seksuale të trajtuara për të cilat po prezantojmë të dhënat si vijojnë:

Viktimat e abuzimit seksual sipas zonave gjeografike


Jugu i Shqipërisë renditet në vendin e parë, përse i përket raportimit të rasteve të dhunës seksuale ndaj fëmijëve me 50 % të rasteve të raportuara, e ndjekur nga Shqipëria e Mesme me 42 % të rasteve të marra në studim, ndërsa Veriu i vendit me 8 % të tyre.



Viktimat e abuzimit seksual sipas grup-moshave

Një këmbanë alarmi është mosha e viktimave të dhunës seksuale ku përgjatë vitit 2019-2021, 40% e fëmijëve të dhunuar seksualisht janë të moshave 10-14 vjeç, dhe 44% të rasteve të trajtuara i përkasin moshës 15-18 vjeç dhe një përqindje akoma dhe më e vogël moshat e mitura 5-9 vjeç.


Numri i fëmijëve viktima të dhunës seksuale të ndarë sipas grupmoshave



Viktimat e abuzimit seksual sipas gjinisë

Grafiku i mëposhtëm jep detaje rreth ndarjes së fëmijëve viktima të dhunës seksuale sipas gjinisë. Sikundër edhe vihet re, gjatë vitit 2020, që përkon me vitin me të vështirë për shkak të pandemisë së krijuar nga COVID-19, vajzat kanë marrë shërbime pranë Qendrës Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna Seksuale. 22 raste të vajzave viktima janë mbështetur nga BARNAHUS për vitin 2020.

Ajo që vihet re për periudhën Janar 2021-Shtator 2021 ka një rritje të numrit të djemve viktima të abuzimit seksual, ku deri më sot 4 djem janë duke u trajtuar nga Qendra.



PROFILI I ABUZUESVE SEKSUALË

- 32% e abuzuesve seksualë i përkasin moshave të reja, pra të mitur dhe të rinj (14-24 vjeç). Ndërsa 21% e rasteve të dhunës seksuale kanë patur si dhunues burra të moshës mbi 55 vjeç.

- Në 17% të rasteve të dhunës seksuale, abuzuesit kanë qenë prindërit ose kujdestarët e fëmijëve viktimë.
- 23% e grabitqarëve seksualë janë të punësuar në administratën publike shqiptare.
- 43% e abuzuesve e kanë kryer krimin seksual në grup me fëmijët viktimë të dhunës seksuale.
- Vetëm për 42% të abuzuesve është arritur të vërtetohet dhuna seksuale ndaj viktimave, ndërsa pjesa tjetër mbetet pretendim i saj.
- 13% e dhunuesve janë persona të cilët kanë arritur nivelin e lartë të arsimit.

Përfundimet: Avokati i Popullit vlerëson punën e bërë nga organizatat jofitimprurëse në drejtim të shërbimeve të ofruara dhe analizës së të dhënave të përpunuara, bazuar në rastet e trajtuara, por në përmbushje të standarteve ndërkombëtare bën thirrjen e vazhdueshme ndaj organeve përgjegjëse të administratës shtetërore për ngritjen e një Qendre Kombëtare për Viktimat e Krimin Seksual në Shqipëri, e cila do të ndihmonte në pasqyrimin e të dhënave cilësore në zbulimin e fenomenit në fushën e abuzimit seksual të fëmijëve në Shqipëri dhe ndikimin shkatërrues afatgjatë në jetën e fëmijës:

Konkluzionet: Pavarësisht, përmirësimeve në zhvillimet e realizuara në sistemin e integruar të mbrojtjes së fëmijës nga të gjitha format e dhunës Avokati i Popullit shpreh shqetësimin lidhur me mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi seksual, pasi analiza e fenomenit në vendin tonë nuk është i qartë, të dhënat janë kontradiktore ndërmjet ASHMDF dhe organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbime me qasje multidisiplinare. Domsdoshmërisht lind nevoja për të siguruar përgjigje të përshtatshme ndaj fenomenit të abuzimit seksual, profilit të abuzuesit dhe ofrimit të shërbimeve kundrejt tyre. Në këtë kontekst, nevojiten burime të tjera për të fuqizuar më së miri njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, ndërsa llogaridhënia, monitorimi dhe mekanizmat e kontrollit të cilësisë duhet të forcohen. Profesionistët e vijës së parë (përfshirë personelin shëndetësor, policinë, mësuesit dhe punonjësit e tjerë) duhet të identifikojnë në mënyrë aktive individët e rrezikuar ndaj dhunës, të referojnë rastet dhe t'i trajtojnë ato kur ndodhin. Disponueshmëria e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe marrja e tyre nga fëmijët duhet të përmirësohet, duke përfshirë shërbimet e specializuara të integruara për fëmijët të mbijetuar nga format e rënda të dhunës dhe abuzimit. Programet e mbështetjes së prindërve për familjet dhe kujdestarët, si dhe mekanizmat e referimit për fëmijët (në shtëpi dhe në mjediset institucionale) duhet të mbështeten, për të transformuar kulturën e tolerancës ndaj dhunës, stigmatizimin e viktimave dhe diskriminimin ndaj të mbijetuarve, si për vajzat ashtu edhe për djemtë në të njëjtën mënyrë.

4. ROLI I INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT NË MBROJTJEN E FËMIJËS NGA ABUZIMI SEKSUAL

Në zbatim të dispozitave kushtetuese⁹⁸ dhe ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, parashikohen kompetencat e institucionit në tërësi dhe, në veçanti, edhe në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës duke parashikuar për herë të parë në 2014, funksionin e Komisionerit të Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijës dhe të një strukture të veçantë Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijës⁹⁹. Ligji nr.18/2017¹⁰⁰, i ngarkon institucionit të AP-së funksionin e veçantë monitorues në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. Pra, veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit për të drejtat e fëmijës, ndërthuret në katër funksione kryesore: atë të **mbrojtjes, promovimit, garantimit dhe monitorimit** të të drejtave të fëmijëve në përputhje me Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe legjislacionin e brendshëm.

Në përmbushjen e funksioneve të veprimtarisë së AP-së në fushën e të drejtave të fëmijës, lidhur me fenomenin e abuzimit apo shfrytëzimit seksual, gjatë periudhës kohore 2018-2021, në sistemin e regjistrimit të rasteve të trajtuara, janë trajtuar rreth **26 raste, ankesa, kërkesa, raste me iniciativë, me objekt abuzimi apo shfrytëzimi seksual i fëmijës**, prej të cilave, 23 raste me iniciativë, një ankesë nga vetë fëmija dhe 2 ankesa nga organizatat e shoqërisë civile. Theksojmë, se nga trajtimi i tyre kanë përfituar një numër më i madh fëmijësh, pasi janë kryer inspektime, monitorime, hetime administrative dhe u janë adresuar rekomandime në vazhdimësi¹⁰¹ organeve të administratës shtetërore për të bërë të mundur garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të abuzuar/dhunuar seksualisht dhe të miturve në konflikt me ligjin.

Institucioni i AP-së me përgjegjshmëri dhe përgjegjësi maksimale është përpjekur të sjellë në vëmendje të autoriteteve shtetërore dhe opinionit publik, se mbrojtja e fëmijës nga abuzimi apo shfrytëzimi seksual është detyrë e të gjithëve, parë kjo në dy aspekte thelbësore:

- ***parandalimin dhe zbutjen e ri-viktimizimit***, duke ndjekur parimet e ndërhyrjeve të specializuara, me qëllim shmangien në mënyrë të panevojshme të hapave të përsëritura hetimore;

⁹⁸ Neni 60 (2) i Kushtetutës: “Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij”.

⁹⁹ Neni 31 (4) i ligjit nr.8454 date 4.02.1999 “Per Avokatin e Popullit”, të ndryshuar

¹⁰⁰ Neni 34 (7) të ligjit 18/2017 “Për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës” parashikon që Avokati i Popullit monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin per Avokatin e Popullit

¹⁰¹ Rekomandimi me nr. K5/Ie7-5prot. datë 2.5.2019; Rekomandimi nr. K5/I46-2 prot, 10.6.2020, Rekomandimi nr.437 prot. datë 11.10.2019

- **aksesi në rehabilitim e viktimës**, me qëllim sigurimin e dëmshpërblimit të shpejtë dhe efektiv për dëmin e shkaktuar. Ky parim kërkon qasje universale në trajtim dhe shërbime, si dhe duke siguruar që të gjithë aktorët e përfshirë të përpiqen për një reagim të menjëhershëm në trajtimin rehabilitues dhe pa vonesa të pajustificuara.

Në këtë këndvështrim konstatohet, se problematikë kryesore në realizimin e të drejtave të fëmijës, vazhdon të mbetet **shkelja e të drejtës për mbrojtjen e fëmijës** nga të gjithë aktorët për një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe gëzimi i një jetese të shëndetshme e pa privime si rrjedhojë e:

- **mungesës së bashkëpunimit** për format, mënyrat e bashkëpunimit që institucionet duhet të kishin ndërmjet tyre, të parashikuara tashmë në legjislacionin për mbrojtjen e fëmijës;
- **mungesës së shërbimeve të reja** në ndjekje të dinamikës së nevojave të fëmijës për mbrojtje, hap pas hapi;
- **mungesës së programeve gjithëpërfshirëse sociale në nivel vendor**, bazuar në një bazë të dhënash të sakta për të bërë të mundur parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin e grupeve në risk;
- **mungesës së buxheteve të nevojshme** të dedikuar për garantimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës;
- **mungesës së instrumentave për fuqizimin e mekanizmave përgjegjës** të kontrollit që garantojnë realizimin efektiv të mbikëqyrjes, llogaridhënies në sistemin e mbrojtjes së fëmijës;
- mungesës së shërbimit të specializuar për fëmijët viktime të abuzimit apo shfrytëzimit seksual në nivel kombëtar;
- **mungesa e rolit proaktiv të profesionistëve të vijës së parë** (përfshirë personelin shëndetësor, arsimor, policisë etj), për identifikimin e fëmijëve të rrezikuar ndaj dhunës.

Çdo fëmijë ka të drejtë për mbrojtje si pjesë e familjes, shoqërisë dhe vendit të tij. Shfrytëzimi seksual i fëmijëve, në veçanti, pornografia, prostitucioni dhe të gjitha format e abuzimit seksual janë shkatërruese për shëndetin e fëmijëve dhe zhvillimit psiko-social. Rritja e dukurisë së shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijët në përmasa shqetësuese, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, veçanërisht në lidhje me rritjen e përdorimit nga ana e fëmijëve të informacionit dhe komunikimit teknologjive (TIK), kërkon bashkëpunim dhe bashkërendim të punës së mekanizmave mbrojtës së fëmijës në nivel horizontal dhe vertikal. Mbrojtja e fëmijës nga çdo formë e dhunës, në vetvete është sfidë, sidomos në ditët e sotme të përdorimit të teknologjisë moderne. Ndaj, është detyrë parësore e institucioneve përgjegjëse shtetërore, të përballen me sfidat e reja, qoftë në aspektin institucional, qoftë në aspektin ligjor.

Institucioni i AP-së ka adresuar një seri rekomandimesh për mekanizmat shtetërorë përgjegjës, pjesë e qenësishme e zinxhirit të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e jetës së fëmijëve në përputhje me profilin dhe nevojat e tyre.

Më konkretisht, ndër rekomandimet më të qenësishme përmendim:

Së pari, në aspektin e garantimit të të drejtave të fëmijëve për mbrojtje sociale dhe kujdes shëndetësor, **Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**:

- **përbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësi për mbrojtjen e fëmijës/viktima të abuzimit seksual** nëpërmjet ofrimit shërbimit të specializuar për fëmijët e dhunuar seksualisht, që do të thotë ngritjen e një qendre të posaçme në nivel kombëtar të specializuar, konfidenciale, ku në mënyrë të dedikuar ofrohen shërbime të specializuara për këta kategori, nga një grup profesionistësh, si: psikolog, psikiatër, neuropediatër dhe punonjës social për rehabilitimin në një periudhë kohore afatgjatë;
- **forcimin e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore nëpërmjet** trajnimeve dhe kualifikimeve të tyre në vazhdimësi, duke ngritur dhe vënë në funksion Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim dhe Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit.
- **garantimin e vazhdimësisë së funksionimit të shërbimeve sociale**, në interesin më të lartë të fëmijës nëpërmjet forcimit të sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të strukturave në nivel vendor, për të bërë të mundur fuqizimin e tyre në zbatim të detyrave funksionale ligjore të legjislacionit të brendshëm;

Së dyti, në aspektin e edukimit të fëmijëve në përputhje me moshën dhe aftësitë e tyre për çështjeve e dhunës dhe format e saj, **Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë**:

- **rishikimin e kurrikulave mësimore në fushën e arsimit parauniversitar** e për trajtimin më të gjerë të temës së abuzimit/dhunës seksuale (konkretisht të lëndës së edukatës seksuale).
- **forcimin e punës për përsosjen e marrëdhënieve mësues-fëmijë/nxënës**: marrëdhënie bashkëpunimi për arritjen e realizimit të veprimtarive të përbashkëta objektive të përbashkëta, për parandalimin e çdo forme të dhunës, nëpërmjet identifikimit dhe referimit në strukturat përgjegjëse të mekanizmit të integruar të mbrojtjes së fëmijës;
- **rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet e internetit të pasigurt e të pakontrolluar**, ndaj fëmijëve, në këtë situatë pandemie;

- ruajtjen e privatësisë dhe imazheve të fëmijëve-nxënës gjatë procesit të të mësuarit *online*, dhe konsolidimin e bashkëveprimit mësues dhe prindër në këtë kontekst, si konsideratë mjaft thelbësore.

Së treti, për garantimin e një drejtësie miqësore për të miturit në konflikt me ligjin, viktima dhe/apo dëshmitarë për Ministrinë së Drejtësisë dhe Ministrinë së Brendshme:

- **informimin e të gjitha strukturave përgjegjëse** për ushtrimin e detyrimeve dhe përgjegjësi në zbatim të legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës dhe **Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit**.

Së katërti, për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, për strukturat e mekanizmit shtetëror përgjegjës të mbrojtjes së fëmijës, në nivel qendror dhe vendor:

- **fuqizimin e strukturave të mbrojtjes së fëmijës**, për parandalimin, identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve të dhunuar;
- **rritja e rolit interaktiv dhe proaktiv të të gjitha strukturave përgjegjëse** në nivel vendor, për identifikimin e fëmijëve/familjeve të riskuara nga çdo formë e dhunës;
- **organizimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe edukative me prindërit dhe anëtarët e komunitetit**, për mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha format e dhunës nëpërmjet strukturave përkatëse të ngritura pranë tyre (psh Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rasteve, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës)

Së pesti, për ushtrimin e kontrollit ndaj veprimtarisë së mediave audiovizive përsa i përket mënyrës se si duhet t'i qasen dhe të trajtojnë çështje të abuzimit/dhunës seksuale tek të miturit, në zbatim të legjislacionit në fuqi nga **Agjencia e Mediave Audiovizive**.

Nga gjenerimi i informacionit zyrtar të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale¹⁰², Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë¹⁰³, si dhe Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës¹⁰⁴, lidhur me zbatimin të rekomandimeve të adresuara nga institucioni i Avokatit të Popullit në maj 2019,¹⁰⁵ theksojmë, se rekomandimet janë pranuar nga të gjitha institucionet e lartpërmendura dhe, disa prej tyre janë zbatuar korrekt. Ndërkohë, për disa rekomandime janë dhënë shpjegimet dhe sqarimet përkatëse për zbatimin e tyre

¹⁰² Shkresa zyrtare me nr. 2502/1 datë 5.6.2019

¹⁰³ Shkresa zyrtare me nr. 4913/1 datë 28.6.2019

¹⁰⁴ Shkresa zyrtare me nr. 155/1port. datë 22.5.2019

¹⁰⁵ Nisur nga publikimi i rasti të abuzimit seksual të minorenes me inicialet Xh.A.

në vazhdimësi. Por, AP gjithmonë ka sjellë në vëmendje, që zbatimi korrekt i disa rekomandimeve në praktikë lë për të dëshiruar.

Vlerësojmë punën e mirë të kryer nga MSHMS për zbatimin korrekt të rekomandimeve të AP të adresuara për mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi seksual, konkretisht:

- thirrjen e mbledhjes së menjëhershme të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës nga znj. Manastirliu, ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në cilësisë e Kryetares të këtij këshilli. Qëllim i realizimit të mbledhjes ishte koordinimi i ndërhyrjeve institucionale për marrjen e masave, në vazhdimësi;
- përmbushjen e detyrave nga ana e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat e Fëmijës, për mbështetjen e drejtpërdrejtë ofruar strukturave të mbrojtjes së fëmijës në Bashkinë Kavajë, lidhur me asistencën e dhënë për menaxhimin dhe zgjidhjen e rastit në fjalë për mbrojtjen e minoreneve viktime apo dëshmitarë;
- vendosjes së sanksioneve për personat fizikë, të cilët me veprimet apo mosveprimet e tyre, kishin shkelur të drejtat e fëmijës, të cilat përbënin kundërvajtje penale.

Ndërsa, për rekomandimet që **nuk janë zbatuar korrekt** nga organet e administratës shtetërore (MSHMS dhe MASR), lidhur me mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi seksual, duke dhënë shpjegimet dhe sqarimet përkatëse për zbatimin e tyre në vazhdimësi konsistojnë në:

Mosngritjen e qendrës të shërbimeve të specializuara për fëmijët e abuzuar seksualisht në nivel kombëtar. Shërbimet e vlerësimit klinik dhe të trajtimit që duhet të ofrohen për të rinjtë që kanë një histori të kryerjes së akteve të dëmshme seksualisht ose kanë qenë vetë viktime. Këto shërbime konsistojnë në Vlerësimin e Rrezikut të Sjelljes Seksuale si dhe Vlerësimin e Traumës së Viktimave për të shmangur rrezikun e një fëmije, për të mos pasur probleme të sjelljes seksuale në të ardhmen. Në varësi të nevojave specifike të trajtimit, ai ose ajo mund të marrë terapi individuale. Trajtimi duhet të fokusohet në planifikimin e sigurisë, përgjegjësinë dhe ndjeshmërinë për viktimat dhe kufijtë e shëndetshëm. Trajtimi i traumës së viktimës fokusohet në shërimin, fuqizimin, kufijtë e shëndetshëm, aftësitë e përballimit dhe zhvillimin e ndjenjës së kontrollit mbi jetën e dikujt. Ky shërbim duhet të konsistojë në nevojën e pjesëmarrjes së familjes për të promovuar suksesin e të rinjve në trajtim. Anëtarët e familjes inkurajohen të bëhen pjesë e procesit të trajtimit, planifikimit të sigurisë dhe integritit të tyre në shoqëri¹⁰⁶.

¹⁰⁶ *Shpjegimet sqaruese të MSHMS konsistojnë:* Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka në vartësi administrative qendrën “LILUM”. Kjo qendër ka si qëllim trajtimin e rasteve, që janë viktime të abuzimit dhe

Mosmarrjen e masave nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për trajtimin e temës së abuzimit dhe dhunës seksuale në kurrikulat shkollore nga institucionet përgjegjëse për hartimin e kurrikulës, e cila aktualisht nuk është konkretizuar në kurrikulat mësimore të arsimit parauniversitar¹⁰⁷.

Plotësimi i kuadrit ligjor për edukimin në vazhdimësi të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, MSHMS ka informuar se janë në proces dy projektvendime në zbatim të ligjit nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, të cilat do të bëjnë të mundur ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, si dhe Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve, me qëllim zbatimin korrekt të rekomandimit për trajnimin dhe kualifikimin e stafeve në nivel vendor të shërbimeve në vazhdimësi, për identifikimin dhe trajtimin e rasteve të viktimave fëmijë të abuzuar seksualisht.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, si organizëm rregullator për fushën e mediave audiovizive ka trajtuar me shpejtësi të gjitha ankesat e mbërritura pranë këtij institucioni për rastin e bërë publik të abuzimit seksual të minorenes me inicialet A.D., si dhe ka kryer monitorimin me përgjegjshmëri të transmetimeve audiovizive për ngjarjen në fjalë. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave dhe monitorimit, AMA ka marrë masa konkrete ndaj operatorit audioviziv, konkretisht tërheqje vëmendjeje për “ABC News” dhe “Vizion Plus”. Në vazhdimësi, AMA thekson, se menjëherë pas kësaj ngjarjeje raportimet në mediat audiovizive për fëmijët dhe rreth fëmijëve, krahasuar me raste të ngjashme të raportuara në vitet e kaluara, është duke u përmirësuar, pasi raportimet janë kryer në zbatim të normave ligjore dhe në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Bashkia Tiranë informon, se ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e kriterëve të posaçme etiko-profesionale për punonjësit në funksionin “roje” që rekrutohen rishtazi, si dhe për punonjësit aktualë të punësuar, duke bërë rifreskimin, sistemimin dhe plotësimin me aktet përaktëse administrative të dosjeve

dhunës seksuale, ku përfshihen edhe fëmijët (në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga GREVIO, në kuadër të raportimit për zbatimin e Konvetës së Stambollit). Qendra ofron shërbime të specializuara socio-shëndetësore me një ekip multidisiplinor në përbërje të së cilit janë profesionistë si: mjek ligjor, gjinekolog, pediatër, psikiatër, psikolog klinik, punonjës social, prokuror, avokatë, infermier. Por, tipologjia e shërbimit është afatshkurtër 24-72 orë, pa dallim moshe, gjinie, etnie, race, orientimi seksual apo aftësie të kufizuar, në përputhje me standardet të miratuara me udhëzimin (Udhëzimi nr. 816, datë 27.11.2018) e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale”). Institucioni i AP-së vlerëson ngritjen dhe funksionimin e kësaj qendre, pse jo edhe marrjen e shërbimeve në të, të fëmijëve që janë abuzuar apo shfrytëzuar seksualisht, deri në momentin e ngritjes dhe funksionimit të qendrës të specializuar për fëmijët e abuzuar seksualisht, pasi *tipologjia e ofrimit të shërbimit, që ofron qendra konsiston në mbështetjen afatshkurtër që merr viktimat për të bërë të mundur menaxhimin e krizës pas abuzimit seksual.*

¹⁰⁷ Shpjegimet sqaruese të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë konsistojnë në: *angazhimin për realizimin e trajnimeve të stafit mësimor, për identifikimin dhe trajtimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht në bashkëpunim me shoqërinë civile.* Pra, kualifikim i stafit pedagogjik nuk mund të lihet vetëm në dorën e projekteve të ndryshme të bashkëpunimit me shoqërinë civile.

individuale të punës, të cilat kanë filluar të riformalizohen në bazë të kritereve të reja të etikës profesionale dhe figurës së pastër të integritetit të punonjësve. Për këtë bashkia i ka kërkuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të vërë në dijeni institucionet arsimore për sigurimin e informacionit të dokumentuar për punonjësit në funksionin “roje”, lidhur me integritetin dhe reputacionin e tyre dhe përcjelljen e letërporosisë pranë këtyre institucioneve të vlerësimit profesional, nëpërmjet plotësimit të një formulari të integritetit etiko-profesional, të parashikuar në urdhëresat përkatëse të Bashkisë Tiranë¹⁰⁸.

Përfundimet: Për të konkretizuar veprimet dhe mosveprimet e organeve të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, Avokati i Popullit në dy rastet e trajtuar të prezantuara në ankeset 1.1 dhe 1.2 me keqardhje dhe të punës së realizuar në këtë drejtim konstaton, se rastet e suksesit të mbrojtjes dhe rehabilitimit të fëmijëve të abuzuar seksualisht, nuk janë në përputhje me parimet dhe standardet e konventave të zbërthyera në mënyrë eksplicite në këtë raport. Konkretisht:

- Rasti i minorenes së trajtuar nga AP, e mitura e abuzuar seksualisht me inicialet Xh.B., u mor në mbrojtje për një periudhë kohore relativisht të shkurtër nga strukturat përgjegjëse të mekanizimit të mbrojtjes së fëmijës dhe, së bashku me familjen e saj u vendosën në shtetin italian, në mungesë të mbështetjes dhe shërbime të specializuara afatgjata për statusin e saj, “*viktimë e dhunës seksuale*”. Sërish, është kthyer në qytetin e Kavajës. Pavarësisht, mediatizimit të çështjes, veprimeve të ndërmarra në aksion për të mbrojtur viktimën fëmijë të abuzimit seksual nga të gjithë aktorët, pjesë e mekanizmit të mbrojtjes së fëmijës, konstatojmë, se e mitura me inicialet Xh.B., **nuk është mbrojtur bazuar në interesin më të lartë të fëmijës dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare.** (Aneksi 1.1)
- Rasti i minorenes me inicialet E.N., 15 vjeç. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e minorenes së abuzuar seksualisht janë brenda mundësive të kuadrit institucional, që legjislacioni i brendshëm parashikon për mbrojtjen e fëmijës dhe shërbimeve të ngritura nga shteti apo shoqëria civile deri tash. Nëse do gjykojmë, a janë këto masa në interesin më të lartë të fëmijës, mendojmë se ofrimi i shërbimeve të fragmentizuara larg familjes, nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, pasi ofrimi i shërbimeve kundrejt fëmijës së abuzuar seksualisht brenda familjes, duke informuar prindërit për mundësinë e integritetit të tij/saj nëpërmjet programeve të rimëkëmbjes

¹⁰⁸ Urdhri nr. 2169, datë 23.6.2020 i drejtorit të përgjithshëm të objekteve publike në Bashkinë Tiranë, “Për rregullimin e praktikave të punës për punonjësit mbështetës në institucionet arsimore parauniversitare transferuar pranë drejtorisë së përgjithshme të objekteve publike dhe urdhrit nr. 2170, datë 23.6.2020, të drejtorit të përgjithshëm të objekteve publike në Bashkinë Tiranë “Për miratimin e kritereve të posaçme dhe formatin e formularit të integritetit etiko-profesional për punonjësit “roje”, të transferuar nga funksionet e pakushtëzuara sektoriale të cilët shërbejnë si punonjës mbështetës në shkollat e arsimit bazë”.

lehtëson dhe ndihmon fëmijën e abuzuar gjatë procesit të rehabilitimit. Ky proces, ndihmon fëmijën e abuzuar të njihet me vlerat, të shpërblehet për arritjet e tyre, të kuptojnë pikat e dobëta dhe të forta dhe në vazhdimësi, merr mbështetjen e nevojshme për të gjetur zgjidhjet për problemet me të cilat është përballur dhe do të përballlet, në mënyrë që të bëhet të nesërmen individ i përgjegjshëm (Aneksi 1.2).

1. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET PËR HARMONIZIMIN E KUADRIT LIGJOR

Në zbatim të funksionit kushtetues, institucioni i AP-së në vazhdimësi, ka vlerësuar përmirësimin e legjislacionit të brendshëm në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, i cili është bashkëkohor dhe parashikon krijimin e strukturave dhe procedurave të reja. Pavarësisht, legjislacionit të mirë të mbrojtjes dhe të garantimit të të drejtave të fëmijës, të sigurosh mbrojtje efektive për fëmijën është e vështirë dhe shkon përtej miratimit të një kuadri ligjor solid.

Strukturat e parashikuara në legjislacion duhet të mbështeten me burime të përshtatshme buxhetore dhe njerëzore për shërbimet sociale dhe gjyqësore, për fëmijët e abuzuar seksualisht, elementë këto, që janë rekomanduar në vazhdimësi nga institucioni i AP-së.

Konkretisht, miratimi i legjislacionit të brendshëm për mbrojtjen e fëmijës në përputhje me standartet më të mira ndërkombëtare, plotëson “*de-jure*” detyrimet ndërkombëtare, pasi ky legjislacion në të vërtetë ka mangësi përse i përket procedurave administrative, mungesës së burimeve njerëzore dhe strukturave ligjzbatuese që bëjnë të mundur zbatimin e tij. Në vazhdimësi, institucioni i Avokatit të Popullit ka shprehur shqetësimet dhe ka adresuar rekomandimet përkatëse, për të bërë të mundur zbatimin efektiv të këtyre 'ligjeve të mira', duke rekomanduar dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të tyre.

Gjatë procesit të monitorimit, AP-ja ka vlerësuar pozitivisht ekzistencën e parimeve dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin e brendshëm, që parashikon mekanizmat monitorues në nivel qendror dhe vendor, si dhe të pavarur për të kërkuar llogari organeve publike për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky legjislacion për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha llojet e abuzimit seksual.

Institucioni i AP-së në hartimin e rekomandimeve për këtë dukuri, është fokusuar edhe në rekomandimet e raportet e publikuara të mekanizmave monitorues të Këshillit të Evropës. Një ndër këto mekanizma është edhe Komiteti i Palëve në Konventën për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi

Seksual (Komiteti Lanzarotës). Ky Komitet ka përgatitur dy raporte, raporti i parë daton në 4 dhjetor 2015 dhe raporti i dytë në 31 janar 2018.

Avokati i Popullit pasqyron më poshtë vlerësimin e rekomandimeve të zbatuara/apo të pazbatuara, që shteti shqiptar ka ndërmarrë në përputhje me rekomandimet e adresuara në këto raporte, konkretisht:

Ligji nr.18/2017 parashikon të gjitha masat dhe parimet e vendosura nga Konventa e Lanzarotës dhe instrumenteve ndërkombëtare të përmendura më sipër të tilla, si masat ndihmëse dhe mbështetëse, masat e bashkërendimit, linjat ndihmëse të komunikimit (helplines), detyrimet e raportimit, masat e trajnimit dhe ndërgjegjësimit, masat kufizuese për personat që punojnë me fëmijët dhe masat mbrojtëse për fëmijët. Ky ligj parashikon dhe fuqizon me përgjegjësi strukturat sociale brenda bashkisë (Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve), të cilat kanë vendimmarrje për miratimin e masave mbrojtëse për fëmijët me risk të lartë. Këto masa mbrojtëse miratohen dhe zbatohen me vendimin e vetë strukturave të bashkisë, përpara se të merret një vendim gjykatë. Në këtë kuptim është pozitive që të ketë struktura të afta për të ndërhyrë dhe për të marrë vendime të rëndësishme për fëmijët, përpara se çështja t'i drejtohet gjykatës. Nga ana tjetër, kjo vendimmarrje është shumë delikate dhe duhet t'u besohet vetëm punonjësve socialë të mirëspecializuar dhe të trajnuar, të cilët vërtet janë në gjendje të identifikojnë rëndësinë e rrethanave dhe të marrin vendimin e duhur, duke pasur parasysh dhe interesin më të lartë të fëmijës. Gjithashtu, Njësitë të Mbrojtjes së Fëmijëve brenda bashkive duhet t'u vihen në dispozicion fondet e nevojshme buxhetore dhe burimet njerëzore me qëllim që të gjitha strukturat të funksionojnë në mënyrë efektive.

Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur parashikon të gjitha parimet dhe standartet ndërkombëtare për trajtimin e problematikave që lidhen me të miturit/fëmijë, viktimat të abuzimit, përfshirë abuzimin seksual. Institucioni i AP-së, miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur e ka konsideruar si një risi, duke patur rol proaktiv në zbatimin e tij. Në këtë kontekst, në vazhdimësi ka evidentuar problematikën dhe ka adresuar rekomandimet përkatëse organeve kompetente të administrimit të drejtësisë penale për të mitur me qëllim funksionimin e këtij sistemi me efektivitet, miratimin e akteve nënligjore, si dhe parashikimin e burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore.

Kodi Penal së fundmi është ndryshuar në vitin 2013, dhe nuk është i harmonizuar me përmirësimet e kryera pas vitit 2017, të legjislacionit të brendshëm të mbrojtjes së fëmijës, sidomos kur flasim për fenomenin e abuzimit seksual të fëmijës. Veprat penale që lidhen me abuzimin seksual të fëmijëve nuk janë të formuluar në përputhje me kërkesat ndërkombëtare, konkretisht:

- Kodi Penal nuk përcakton qartë abuzimin seksual dhe homoseksual. Dallimi konsiston vetëm në identifikimin e këtyre abuzimeve, si dy forma të ndryshme, por jo në shkallën e dënimit që është e njëjtë për të dyja. Ky element është identifikuar në raportin e parë të Komitetit të Lanzarotës të vitit 4 dhjetor 2015¹⁰⁹, në të cilën theksohet dallimi midis abuzimit seksual dhe abuzimit homoseksual, si dy vepra penale të ndryshme.
- Neni 100, i Kodit Penal¹¹⁰ parasheh masën e dënimit për marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me të miturit, që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç. Aktiviteti seksual ose homoseksual me të miturin që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nga mosha është i dënueshëm, por formulimi i këtij neni me togfjalshin “.....me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale....”, gjen zbatim vetëm për fëmijët e seksit femër, gjë që përbën sërish një diskriminim gjinor dhe duhet të ndryshojë.
- Neni 106 i Kodit Penal parashikon dënimin për marrëdhëniet seksuale ndërmjet personave të lidhur të tillë si: prindërit dhe fëmijët, vëllezërit dhe motrat, ose prindërit birësues dhe kujdestarët, me qëllim parandalimin e marrëdhënieve seksuale ndërmjet anëtarëve të familjes (incestit), qoftë kjo familja biologjike apo jo biologjike. Por, në formulimin e këtij neni nuk janë përfshirë persona të tjerë që kanë lidhje të drejtpërdrejta me fëmijët të tillë: të afërmit me lidhje gjaku, punonjës të shërbimeve publike në arsim, shëndetësi, mbrojtje, shërbime sociale, etj. Ky nen duhet të përmirësohet dhe të formulohet në përputhje me parashikimet e Konventës së Lanzarotës¹¹¹.
- Neni 103, i Kodit Penal parashikon veprën penale të abuzimit seksual kundër personave të pazotë për t’u mbrojtur (ku përfshihen, personat me aftësi të kufizuara fizike ose mendore), por nuk përcakton kufijtë e moshës. Pra, veprimtaria seksuale kundër fëmijëve nëpërmjet abuzimit të një situatë të veçantë të fëmijës, siç është aftësia e kufizuar mendore ose fizike ose një situatë varësie, nuk është e rregulluar plotësisht në Kodin Penal. Kjo dispozitë nuk është në përputhje me parashikimet e Konventës së Lanzarotës. Në këtë kontekst, duhet të miratohet një nen i veçantë që dënon abuzimin seksual ndaj fëmijëve të gjendur në këto rrethana të brishta ose, të parashikohet ky lloj abuzimi ndaj fëmijëve si rrethanë rënduese në këtë nen.
- Neni 66 i Kodit Penal rregullon parashkrimin e ndjekjes penale. Ndërkohë që neni 33 i Konventës së Lanzarotës parashikon, se ndjekja penale për

¹⁰⁹ Komiteti i Lanzarotës, 1st Raporti i zbatimit, “*Protection of children against sexual abuse in the circle of trust: The framework*”, fq.15.

¹¹⁰ Parashikimi i këtij neni është në përputhje me Konventën e Lanzarotës dhe me kërkesat e Direktivës 2011/92/EU

¹¹¹ Komiteti i Lanzarotës, 1st Raporti i zbatimit, “*Protection of children against sexual abuse in the circle of trust: The framework*” nxit **Shqipërinë** të rishikojë legjislacionin e saj në mënyrë që të bëjë të mundur procedurat sipas detyrës zyrtare në të gjitha rastet e abuzimi i pretenduar seksual në rrethin e besimit.

çështjet e abuzimit seksual të fëmijëve duhet të jetë i mjaftueshëm, që të lejojë viktimën të nisë proceset gjyqësore, pasi të kenë mbushur moshën madhore. Përmes, interpretimit të përbashkët të nenit 66 KP-së me nenet specifike të abuzimit seksual të fëmijëve, mund të llogaritet se afati i parashkrimit të ndjekjes penale për veprat penale kryesore është 10 vjet pas kryerjes së veprës penale (20 vjet kur zbatohen rrethana rënduese: dëmtime të rënda të fëmijës, vdekja, vetëvrasja etj.). Logjikisht, afati prej 10 vitesh është tepër i shkurtër që fëmijët të marrin veten nga përvoja traumatike dhe të marrin guximin për të denoncuar abuzimin, abuzuesin veçanërisht kur kjo ka ndodhur brenda rrethit të besimit. Duke marrë parasysh seriozitetin e veprave penale në fjalë, rekomandohet që këto lloj veprash penale të përjashtohen nga parashkrimi i ndjekjes penale, siç bëhet edhe për disa lloj vrasjesh. Duhet patur parasysh, se abuzimi seksual dëmton jo vetëm fëmijën e së tashmes, por edhe të rriturin e së ardhmes, duke shkaktuar kështu një dëm të madh për individin dhe shoqërinë në tërësi. Me qëllim që ky nen të jetë në përputhje me Konventën e Lanzarotës, afati i parashkrimit të ndjekjes penale duhet të lidhet me mbushjen e moshës madhore të fëmijës dhe duhet t'i garantohet viktimës një kohë e mjaftueshme.

Rekomandimet për hapat që duhen ndërmarrin vendet (ku përfshihet edhe Shqipëria), për të përmirësuar zbatimin efektiv të Konventës së Lanzarotës në raportin e dytë të tij ¹¹² janë në përputhje me rekomandimet e adresuara nga Avokati i Popullit¹¹³ si më poshtë vijon:

- **marrja e masave për të monitoruar** ose mbikqyrur personat e dënuar **për abuzim seksual të fëmijëve në rrethin e besimit** të fëmijës;
- marrjen e masave që duhet të ndërmerren **për të përmirësuar zbatimin efektiv për forcimin dhe bashkëpunimin me median**, me synim të inkurajojnë sigurimin e informacionit të duhur në lidhje me abuzimin seksual të fëmijët në rrethin e besimit dhe respektimit të së drejtës së fëmijës viktimë apo dëshmitar;
- marrjen e masave që **veprimtaritë ndërgjegjësuere të synojnë që fëmijët duhet të jenë në moshë të përshtatshme dhe të përdorin metodat interaktive**, si dhe informacioni të jetë në përputhje me zhvillimet e reja të teknologjisë së komunikimit. Këto veprimtari ndërgjegjësuere duhet të përqendrohen në rrethet dhe realitetin e fëmijës së abuzuar seksualisht në rrethin e besimit për të qënë të vazhdueshëm dhe sistematik. Këto veprimtari duhet të përfshihen në planet e tyre kombëtare të veprimit për të drejtat e fëmijëve;
- vendosjen e programeve ose masa efektive ndërhyrëse për personat, përfshirë edhe fëmijët, të cilët kanë frikë të raportojnë me qëllim

¹¹² Raporti janar 2018

¹¹³ Raporti i Kavajës

parandalimin e kryerjes së veprave. Në këtë kuptim duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë fëmijëve që kanë frikë të raportojnë;

- **plotësimin e nevojave zhvillimore të fëmijëve me programe konkrete të edukatës seksuale**, përfshirë edhe ata që janë nën moshën e përgjegjesisë penale, me qëllim që duke u ofruar atyre programe të tilla mësimore të ndihmohen për të parandaluar kryerjen e veprave penale.

Për sa më sipër, në përfundim në mënyrë që të bëjmë të mundur harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me veprat penale që lidhen me abuzimin seksual të fëmijëve të Kodit Penal, tash domosdoshmërisht lind nevoja e formulimit të qartë dhe jo-diskriminues të dispozitave të këtij Kodi në përputhje me dispozitat e parashikuara në Konventën e Lanzarotës dhe rekomandimeve të raporteve të Komitetit të Lanzarotës.

Por, ajo që është më e rëndësishme, është ndërgjegjësimi dhe informimi i të gjithë shoqërisë, se nëse duam të minimizojmë dhe reduktojmë dukurinë e dhunës dhe abuzimit seksual të fëmijëve, përparësi merr thyerja e mentaliteteve 'tabu' dhe kulturave të heshtjes, si një ndër format më efikase në luftën kundër kësaj dukurie negative.

Dhuna seksuale ndaj fëmijëve është një çështje komplekse, që kërkon maksimizimin e përpjekjeve dhe bashkëpunimin nga të gjithë aktorët e shoqërisë, të cilët janë të gatshëm, kanë dëshirë dhe janë gati të veprojnë.

Fëmijët janë e tashmja dhe e ardhmja jonë. Ne duhet të vazhdojmë të përdorim mekanizma efikasë, për t'i siguruar ata, që askush dhe asgjë nuk ua vjedh të ardhmen!

Aneksi 1.1

Rasti i abuzimit seksual në Kavajë

E mitura me inčialet Xh. B. (14 vjeç) kryen marrëdhënie seksuale me të miturin me inčialet E.H., (14 vjeç), shokë të një klase (kishin simpati për njëri tjetrin). Ky akt, filmohet nga minorenit me inčialet E.A (14 vjeç). Kjo video përdoret, si mjet presioni ndaj të miturës me inčialet Xh.B., të cilën e detyrojnë të kryejë marrëdhënie seksuale me forcë me 6 shokë të tjerë të minorenit me inčialet E.A., konkretisht, me minorenët me inčialet K.K.,(17 vjeç), K.M., (14 vjeç), F.M., (16 vjeç), E.M., (14 vjeç), L.L., (14 vjeç).

Rasti në fjalë është kompleks, pasi të dy palët, si pala e abuzuar seksualisht, ashtu dhe pala abuzuese, janë të mitur.

Përfaqësues nga institucioni i edukimit në të cilin e mitura me inčialet XH.B, vazhdonte procesin mësimor, vihen në dijeni për ushtrim presioni ndaj të miturës në fjalë, për të kryer marrëdhënie seksuale me një shok të klasës së saj. Njoftohet mësuesja kujdestare, pyetet e mitura me inčialet Xh.B., dhe shoku i klasës së saj dhe referohet rasti në drejtorinë e shkollës. Gjithashtu, vihen në dijeni prindërit e të dy palëve dhe ri-merren në pyetje nxënësit nga drejtuesi i shkollës, psikologjia, prindërit. Pastaj, referohet rasti tek përgjegjësja e Zyrës Arsimore Kavajë dhe psikologjia e shkollës njofton me celular Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës, Kavajë. Përgjegjësja e Zyrës Arsimore Kavajë kontakton në telefon zëvendëshefin e komisarariatit, Kavajë, duke e vënë atë në dijeni për ngjarjen e ndodhur. Ky i fundit ka marrë kontakt me babain e vajzës, për të garantuar prindin e të miturës viktimë dhe njëkohësisht dëshmitare, se ai duhet të kallëzonte ngjarjen dhe, se ajo do të ndiqej në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe parimin e konfidencialitetit, sipas dispozitave të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Pas garancisë, se çështja do të ndiqej në rrugë ligjore dhe rasti nuk do të bëhej publik, prindi i të miturës ka pranuar t'a çojë vajzën e tij në Komisarariat për të kallëzuar ngjarjen.

Duke qenë se bëhej fjalë për një rast, në të cilin e dëmtuara ishte e mitur viktimë dhe njëkohësisht dëshmitare¹¹⁴, Komisaritati i Policisë Kavajë ka marrë kontakt me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Seksioni për të Mitur, për të kërkuar mbështetjen e tyre në kryerjen e veprimeve procedural. Meqenëse, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë nuk ka seksion të dedikuar për trajtimin e çështjeve penale me të mitur, prokurori i gatshëm i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Durrës ka shkuar në Kavajë, së bashku me psikologjen e prokurorisë dhe avokatin e caktuar kryesisht.

¹¹⁴ Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur, neni 3, pikat 5 dhe 6:

5. "I mitur viktimë" është çdo person nën moshën 18 vjeç, të cilit i është shkaktuar dëm moral, fizik ose material, si pasojë e një vepre penale;

6. "I mitur dëshmitar" është çdo person nën 18 vjeç, i cili mund të ketë informacion lidhur me veprën penale.

E mitura, e shoqëruar nga nëna e saj, e cila në respektim të pikës 2, të nenit 42, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur¹¹⁵, ka bërë kallëzim në lidhje me ngjarjen e ndodhur, në prani të nënës, prokurores, mbrojtësit ligjor, psikologes dhe oficerit të policisë gjyqësore të komisariatit Kavajë. E mitura është dërguar për ekspertim mjeko-ligjor pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore në Tiranë. Pas marrjes së kallëzimit nga e mitura viktimë, nga ana e prokurorit të gatshëm janë lënë detyra me shkrim, lidhur me veprimet që do të kryheshin nga ana e komisariatit në vijimësi. Në zbatim të këtyre detyrave, u janë marrë deklaratime personave që mund të kishin dijeni për ngjarjen: mësueses kujdestare, psikologes së shkollës e drejtoreshës së shkollës. Pasi, është bërë identifikimi i personave të dyshuar, ka rezultuar, se ata janë të mitur në konflikt me ligjin, në kuptim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur¹¹⁶. Këta shtetas të mitur kanë deklaruar në cilësinë e personit nën hetim. Të miturit janë marrë në pyetje në cilësinë e personit nën hetim, në praninë e prindit/kujdestarit ligjor, psikologut dhe mbrojtësit ligjor, në përputhje me pikën 1, të nenit 49, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Në vazhdimësi, janë kryer veprimet procedurale në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku Komisariati i Policisë Kavajë, i ka referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, Seksionit për të Mitur, materialet procedurale për veprën penale “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal.

Analiza e veprimeve të kryera për mbrojtjes së fëmijës dhe drejtësisë penale për të mitur

Abuzimi seksual përkufizohet si çdo akt që detyron ose josh një fëmijë ose një të ri të marrë pjesë në aktivitete seksuale. Nisur nga ky përkufizim, rasti në fjalë, qartësisht pasqyron elementë të këtij akti, për të vënë në dijeni strukturat përgjegjëse të policisë ose Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës në bashkinë Kavajë për të kryer *vlerësimin dhe ndërhyrjen*, dy përbërës të procesit të mbështetjes së ndihmës, secila me një qëllim specifik. Këta përbërës së këtij procesi, synojnë, së pari sigurimin e nevojave biologjike dhe psikologjike të fëmijës. Njohja e rastit nuk ndalet në fazën e vlerësimit, pasi vlerësimi bëhet në mënyrë, që të mos përkeqësohet gjendja e fëmijës, por të përmirësojë këtë proces në aspektin e tij kurativ. Me grumbullimin e të dhënave në lidhje me abuzimin e fëmijës, është e nevojshme të sqarohen kufijtë që profesionistët duhet të marrin parasysh, në mënyrë për të shmangur ekzagjerimin ose nënvlerësimin. Për rastin në fjalë, në

¹¹⁵ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, neni 42/ 2 (Rregulla të veçanta të pyetjes së të miturit viktimë/dëshmitar nën 14 vjeç): Pyetja e të miturit nën moshën 14 vjeç mund të bëhet vetëm me pëlqimin dhe në praninë e përfaqësuesit të tij ligjor/procedural, psikologut dhe mbrojtësit të tij. Përfaqësuesi ligjor/procedural ka të drejtë të shprehë mendimin e tij për pyetjet që do t'i drejtohen të miturit.

¹¹⁶ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, neni 3, pika 4: “I mitur në konflikt me ligjin” është çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri nën moshën 18 vjeç, ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një veprë penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale”

mungesë të aftësive njohëse të burimeve njerëzore për menaxhimin e situatave të tilla (mësuesi kujdestar, drejtuesi i shkollës, psikologjia) me dashje apo jo kanë dëmtuar gjendjen psikologjike të fëmijës me inçialet XH.B., duke e marrë dhe rimarrë në pyetje. Ndërkohë, kemi Punonjësen e Mbrojtjes së Fëmijës, në bashkinë Kavajë, që edhe pse është vënë në dijeni nëpërmjet telefonit nga psikologjia e shkollës, nuk reagon për të marrë në mbrojtje të miturën në zbatim të legjislacionin në fuqi.

Në rastin në fjalë, për abuzimin e fëmijës me inçialet Xh.B., në aspektin e parë të procesit të vlerësimit është faza e *hetimit*, e cila synon të mbledhë informacion për të konfirmuar ose hedhur poshtë dyshimin për kryerjen e keqtrajtimit nga personat që supozohet të kenë kryer këtë akt ndaj të miturës. Hetimi është realizuar nga përfaqësuesit e Komisarariatit të Policisë së shtetit Kavajë, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës menjëherë pas njoftimit nga Zyra Arsimore e Kavajës, në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Ky proces hetimi ka qenë i fragmentarizuar, pasi strukturat përgjegjëse të organeve të drejtësisë (komisarjati i Policisë së Shtetit Kavajë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës) kanë kryer veprimet hetimore për rastin në fjalë, me prezencën e psikologut të seksionit të të miturve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Durrësit, pa vënë në dijeni Punonjësin për Mbrojtjen e Fëmijës të Bashkisë Kavajë. Prezenca e Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijës, ka rëndësi thelbësore në procesin e vlerësimit, pasi ky proces synon të vërtetojë të vërtetën për atë që ndodhi, në cilat rrethana është kryer abuzimi ose fëmija është lënë pas dore dhe, në cilat kategori keqtrajtimi bien këto fakte. Analizimi i rrethanave dhe fakteve, detyron Punonjësin e Mbrojtjes së Fëmijës të mbledhë Grupin Teknik Ndërsektorial dhe për rastin në fjalë domosdoshmërisht lind nevoja e prezencës së psikologut klinik, pasi një pjesë tjetër e vlerësimit është *diagnoza*, e cila mbulon një fushë të veçantë vlerësimi. Përkatesisht, diagnozën psikologjike të personalitetit të fëmijës ose personave që kanë kryer abuzimin, që për rastin në fjalë janë fëmijë të mitur. Vlerësimi psikologjik dhe psikodiagnostikimi i fëmijës së abuzuar, si dhe familjes së tyre është detyrë e një psikologu klinik. Një ndër objektivat e këtij vlerësimi është “*fëmija në qendër*” si dhe hetimi psikologjik i familjes. Ky vlerësim bazuar në metoda të standartizuara, teknika dhe mjete, të cilat janë të vlefshme për specifikimin e llojit, intensitetit dhe pasojave psikologjike të çrregullimeve psikiatrike dhe të sjelljes kërkon periudhë të gjatë kohore, pasi puna e kryer bazohet në lidhjen e një numri të madh informacionesh, vëzhgimesh, matjesh dhe testimesh të objektivave psikodiagnostikes së vendosur. Në rastin në fjalë, ky vlerësim duhet të përfshinte edhe personat abuzues, të cilët janë të mitur dhe kanë mbrojtje të veçantë për vetë statusin e tyre fëmijë.

E mitura me inçialet XH.B., së bashku me familjen e saj, vetëm pas ndërhyrjes së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijës kanë marrë shërbime psiko-terapeutike pranë Qendrës për Viktimat e Abuzimit Seksual në QSUT, qendra

“Lilium”, e cila jep shërbime të specializuara socio-shëndetësore me një ekip multidisiplinor në përbërje të së cilit janë profesionistë si: mjek ligjor, gjinekolog, pediatër, psikiatër, psikolog klinik, punonjës social, prokuror, avokatë, infermier me tipologji shërbimi 24-72 orë, për menaxhimin e krizës, por jo mbrojtjen afatgjatë të elementëve të vleresimit dhe kurimit.

Aneksi 1.2

Rasti i abuzimit seksual në Mirditë

Minorenia me inicialet E.N., 15 vjeç ka dalë me të dashurin e saj me inicialet A.Gj., 17 vjeç. Nën ndikimin e mesazheve shantazhuese është detyruar të kryejë marrëdhënie seksuale me forcë me shtetasit Artan Gjinkolaj, Albert Moshë, Nik Lleshi, Ermal Tarazhi dhe Adrijano Gjinkolaj.

Për rastin në fjalë, vlerësojmë progresin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës ndërmjet Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës në Bashkinë Mirditë dhe komisarariatit të Policisë së Shtetit, pasi këta të fundit venë në dijeni NJMF. Gjatë realizimit të procesit të *vlerësimit dhe ndërhyrjes*, NJMF në Bashkinë Mirditë kontakton me familjarët për grumbullimin e të dhënave, të cilat ndihmuan Punonjësën e Mbrojtjes së Fëmijës për t'ju ofruar ndihmën e menjëhershme, mbështetjen psiko-sociale për të miturën dhe familjen nëpërmjet një organizate të shoqërisë civile (CRCA/ECPAT) që ofron shërbime për fëmijët viktime të abuzimit seksual. Më pas, Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës me informacionin e grumbulluar, menjëherë, pas ndihmës së ofruar për të miturën dhe familjen, mbledh Grupin Teknik Ndërsektorial për të diskutuar problematikat e identifikuar nga informacioni i mbledhur dhe marrjen e vendimeve lidhur me objektivat e vlerësimit "*fëmija në qendër*", pjesë e qenësishme e Planit Individual të Mbrojtjes (PIM) afatgjatë me dakordësinë e familjarëve dhe të miturës së abuzuar seksualisht, bazuar në nevojat e familjes dhe pasojave psikologjike të çrregullimeve psikiatrike të identifikuar tek e mitura. Objektivat e vendosura në PIM, mundësuan ofrimin e shërbimeve psiko-terapeutike në një qendër emergjence të specializuar të licensuar nga autoritetet përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale për fëmijët viktime të abuzimit seksual me psikolog klinik (Qendra Plan&Go) për një periudhë kohore 21 ditore. Ndërsa, për mbështetjen juridike falas u vendos të ofrohej nga organizata e shoqërisë civile (CRCA/ECPAT). Në përfundim të afateve të përmbushjes së objektivave të vendosura për mbështetjen psikologjike të të miturës së abuzuar u caktua dhe data e takimit tjetër të GTN. Paralelisht, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, realizoi fazën e hetimit. Në takimin e radhës, Grupi Teknik Ndërsektorial ka marrë vendimin e largimit të të miturës me inicialet E.N. nga qyteti, dhe vendosjen në një shkollë me konvikt në një qytet tjetër, së bashku me motrën e saj, duke i siguruar një bonus qeraje dhe të gjitha ndihmat e mundshme.

Për sa më sipër, sjellim në vëmendje që familja ka rolin qendror në sigurimin e kushteve të nevojshme për tranzicionin që ndodh në fazat e zhvillimit të fëmijërisë, element i rëndësishëm në ndërtimin e strukturës së personalitetit të individit. Ndërkohë, faktorët shoqërorë dhe modelet social-kulturor ndërveprojnë në integrimin e individit në shoqëri. Në këtë kontekst, është e vështirë të gjykojmë veprimet e ndërmarra nga GTN lidhur me largimin e minorenes me inicialet E.N.

dhe vendosjen e saj në një mjedis tjetër shoqëror, pa familjen. Por, elementët që identifikojmë janë fragmentizimi i shërbimeve mbështetëse nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile, në përputhje me tipologjitë e shërbimeve që ofrojnë për këtë kategori përfituesish, fëmijë të abuzuar seksualisht.

Bibliografia

- *Raporti “Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri Një Studim Cilësor mbi Perspektivat dhe Perceptimet e Profesionistëve, Prindërve dhe Fëmijëve” Dhjetor 2015, Terre des Hommes*
- *Raporti “Abuzimi i fëmijëve në familje” Children’s Human Rights Centre of Albania - CRCA; Gusht 2005, Tiranë*
- *“Studimi Epidemiologjik Ballkanik mbi Abuzimin dhe Neglizhimin e Fëmijëve” (Balkan Epidemiologic Study on Child Abuse and Neglect, BECAN, Mars 2013*
- *“Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri” Raport i të dhënave të ALO 116 për periudhën 2009 – 2014, 2014*
- *“Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri”, Qendra e Zhvillimit Human, 2006 financuar nga UNICEF*